



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISE

STUDIMET POST DIPLOMIKE – CIKLI I DYTE

**POLITIKAT QEVERTARE DHE KOMUNALE
NË PËRKRAHJE TË NDËRMARRËSISË DHE
BIZNESEVE NË KOSOVË, RAST STUDIMOR
KOMUNA E GJILANIT**

Kandidati:

Besian SELMANI

Mentori:

Prof.dr.Shpresa SYLA

Tetovë, 2019

Falënderime dhe mirënjohje

Së pari falënderojë Zotin që më ka dhënë shëndetin, për të arriturat e mia deri këtu ku jam, pastaj Familjen time, që më ka financuar, dhe mbështetur vazhdimisht, deri në përfundim të studimeve, duke mos kursyer asgjë për mua.

Falënderoj mentoren time doc.dr. Shpresa Syla e cila më ka motivuar dhe nxitur pa hezitim që të arrij në këtë pikë të suksesit, që më lehtësoi realizimin e këtij punimi, poashtu falënderojë prof.dr Rufe Osmanin dhe assoc.pr. Hyrije Abazin për ndihmën dhe përkrahjen e palodhëshme gjatë gjithë kohës duke mos e anashkaluar të gjithë stafin e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë.

Abstrakt

Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi përshkak të zhvillimit të ulët ekonomik që ka komuna e Gjilanit dhe normës së lartë të papunësisë, që mbretëron për momentin në komunë.

Unë jam përpikur që sado pak të jap një kontribut të vogël në këtë drejtim, duke i marrë parasysh edhe sfidat e kohës, me qëllim që të analizohen, shkalla e papunësisë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), procesi i privatizimit, si faktor kryesor që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Për realizimin e temes në fjalë do të përdoret metoda krahasimore, dhe të dhënat sekondare duke u bazuar në periudhën nga viti 2005 deri në vitin 2015, duke identifikuar, problemet dhe sfidat që e përcjellin komunën vazhdimisht nga viti në vit, duke hulumtur këtë fenomen, për hartimin e një strategjie, sa më optimale dhe implementuese

Nën këto kushte të konkurrencës së krijuar, zhvillimi ekonomik i vendit mundësohet vetëm me ndihmën institucionale, si dhe me mbështetjen që ka në fokus forcimin dhe zhvillimin e bizneseve private që do të reflektojnë në zhvillimin ekonomik.

Fjalët kyçe: NVM-të, ZHEL, Procesi i Privatizimit, shkalla e papunësisë, sektori privat.

Abstract

Due to current low economic development and high rate of unemployment the Municipality of Gjilan is enduring, it is of a capital importance that the topic be treated urgently.

Taking into account the present time challenges, the thesis is an attempt to give a small contribution to the topic, in order to analyse the unemployment rate, small and medium enterprises (SMEs), the privatisation process of public and social enterprises, as a key factor that has an impact in local economic development.

The thesis will take advantages of comparative methodology and the second data based on the time frame from 2005 until 2015, by identifying problems and challenges that the municipal authorities are continuously encountering **each** year; by exploring this phenomenon to come to a **feasible and realisable** development strategy.

Under the given competition, economic development of the country is only provided through institutional assistance and the support focusing on strengthening and developing private sector which on the other hand contributes to its economic development.

Key words: SMEs, LED, Privatisation Process, Unemployment Rate, Private Sector

Përmbajtja

Falënderime dhe mirënjohje	2
Abstrakt.....	3
Abstract.....	4
Qëllimi i hulumtimit	7
Metodologjia e Hulumtimit.....	8
Hipotezat.....	9
Kufizimet e punimit	9
Shkurtesat.....	10
Hyrje	11
KAPITULLI I	14
1.1 STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS SË GJILANIT NË PERIUDHËN 2005 – 2015?	14
KAPITULLI II.....	25
2.1 Lehtësitë fiskale, ekonomike të të bërit biznes në komunën e Gjilanit, hapja dhe zhvillimi i tyre, nga qeveria qendrore e Kosovës dhe nga pushteti Komunal?	25
2.1.1 Koncepti i politikës fiskale	29
2.1.3 Ndikimi i reformave ligjore në ambientin afarist në Kosovë.....	30
2.2 Përdorimi i teknologjise informative per te ofruar sherbimet on-line.....	33
2.2.1 Zhvillimi i politikave efektive per te nxitur pjesemarrjen e qytetareve	33
2.2.2 Strategjite e veprimit per arritjen e objektivit strategjik	35
2.3 Historiku i shkurtër i ekonomisë dhe menaxhmentit?.....	35
2.3.1 Zona ekonomike?.....	36
2.3.2 Zona ekonomike ne Gjilan.....	37
2.4 Inkubatori i biznesit?.....	38
2.5 Parqet industriale?.....	39
2.5.1 Përshkrimi teknik i zones industriale per bizneset e vogla dhe te mesme	39
2.5.2 Specifikacioni i hapësirave	40
2.5.3 Lokacioni	40
2.5.4 Infrastruktura.....	40
KAPITULLI III.....	42
3.1 Industria në komunën e Gjilanit dhe themelimi i tyre ne shekullin e kaluar?.....	42
3.2 Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike?	42
3.2.1 Efektet e Privatizimit ne zhvillimin ekonomik te komunes se Gjilanit?	42

3.3 NVM-të dhe krijimi i tyre në komunën e Gjilanit?	47
3.4 Infrastruktura fizike për biznes?	50
3.5 Strategjia e zhvillimit të planit strategjik?	51
3.6 Strategjia për gratë ndërmarrëse në komunën e Gjilanit?	51
KAPITULLI IV	54
4.1 Sistemi i edukimit, shkollimit dhe aftësimit profesionalë të banorëve të komunës?	54
4.3 Hapësirat apo tokat bujqësore?	55
4.4 Hapësirat e zonave industriale?.....	57
KAPITULLI V	58
5.1 Lehtësimet e infrastruktures elektronike lokale ne ofrimin e sherbimeve te ndryshme komunale, si dhe ne berjen e biznesit?	58
5.2 Lista e bizneseve që operojnë në komunën e Gjilanit dhe numrit të të punësuarëve?	62
5.2.1 Lista e bizneseve sipas veprimtarise dhe numrit te te punesuaeve ne komunen e Gjilanit. 62	
5.3 Bashkepunimi nderkufitar per zhvillim ekonomik lokal te komunes?	64
5.4 Programet zhvillimore	65
5.5 Vleresimi i kapaciteteve investuese	65
5.5.1 Investimet në komunën e Gjilanit gjatë periudhës 2008-2015.....	66
5.6 Parimet e pergjithshme per zhvillim	66
5.7 Qendra komunale për regjistrimin e bizneseve.....	67
5.8 Norma e papunesise ne komune dhe implementimi i politikave fiskale per uljen e saj.....	69
5.8.1 Zhvillimi i paplanifikuar dhe shkalla e lartë e papunesisë?	69
5.9 Lista e ndermarrjeve te anketuara ne baze te pyetesoreve qe i posedojme dhe rezultatet e tyre	70
.....	75
Konkluzione dhe rekomandime	76
Bibliografia	78

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë kryesisht me identifikimin e faktorëve si në vijim: Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), si janë zhvilluar dhe rritur ndër vite, Shkalla e lartë e papunësisë, ende mbetet fenomen i pa zgjidhur, Procesi i privatizimit i ndërmarrjeve publike si ka ndikuar në zhvillimin ekonomik lokal, Inkubatori i biznesit, parqet industriale e kështu me radhë, mandej duke i analizuar të gjithë këto faktorë një nga një, në mënyrë detale, duke na shërbyer si udhërrëfyes, për hartimin e strategjisë se si do të jetë komuna për 10 vitet e ardhshme.

T'i sigurojë komunitetit dhe qeverisjes vendore, respektivisht lokale një dokument sa do qofte i vogël, orientues në përcaktimin e drejtimeve kryesore në dobi të rritjes ekonomike, dokument i cili është në proces të përmirësimit, por jo mohimi prej atyre që janë vendimarrës në komune, duke marrë parasysh se suksesi ekonomikë ndikon në cilësinë e jetesës së komunitetit.

Në vazhdim të këtij punimi pretendojmë t'i parashtrojmë këto pyetje të cilat do të shtjellojmë në kapitujt vijues,

1. Cilat janë prioritetet e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal në komunën e Gjilanit dhe cilat rezultate janë realizuar në periudhën e analizuar ,
2. Cilat janë lehtësit fiskale, ekonomike dhe të tjera në hapjen dhe zhvillimin e bizneseve nga qeveria qendrore e Kosovës dhe nga pushteti komunal i Gjilanit ,
3. Sa ka ndikuar privatizimi i ndërmarrjeve publike në krijimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin ekonomik të komunës së Gjilanit?
4. Cilat janë sfidat e identifikuara në krijimin e kushteve lehtësuese për regjistrimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme?
5. Çfarë janë lehtësimet e infrastrukturës elektronike në ofrimin e shërbimeve të ndryshme komunale, si dhe në bërjen e biznesit?

6. Cili është kontributi i masave lehtësuese qeveritare dhe komunale të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në komunën e Gjiçanit në zhvillimin ekonomik me theks të veçantë në uljen e normës së papunësisë në periudhën e analizuar ?

Metodologjia e Hulumtimit

Duke shfrytëzuar literaturën ekzistuese, punimet shkencore të vendit dhe të huaja lidhur me zhvillimin ekonomik lokal, kryesisht në fokus të ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-ve).

Teknikat e shfrytëzimit të burimeve dytësore e kombinuar me teknikën e grumbullimit të të dhënave parësore më kanë krijuar mundësinë për të nxjerrë disa konkluzione dhe rekomandime që i vlejnë mjedisit për të përmirësuar statusin e ndërmarrjeve dhe funksionimin e tyre në bazë të legjislacionit komunal me shpresën se kjo do t'i shërbejë emancipimit dhe zhvillimit në të gjitha sferat për komunën time posaqërisht përmes atij ekonomik. Për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem në mënyrë të gjithanshme kemi përdorur këto metoda të hulumtimit:

Metoda e analizës

Metoda përshkruese dhe

Metoda krahasuese

Hipotezat

H1. Privatizimi i ndermarrjeve publike, ka ndikuar ne zhvillimin ekonomik ne komunen e Gjilanit.

H2. Lehtesite fiskale ekonomike dhe te tjera nga qeveria qendrore e Kosoves dhe nga komuna e Gjilanit ndikojne ne hapjen dhe zhvillimin e bizneseve komunale ne Gjilan.

Kufizimet e punimit

Në bazë të hulumtimeve të bëra për të iguruar të dhëna sekondare sa i përket temës në fjalë dhe në mungesë të informacioneve më të hollësishme, për të analizuar të gjithë sfidat me të cilat po përballlet komuna e Gjilanit, jam përpikur që sadopak të i përmbledhë të gjithë faktorët që në të ardhmen do të na nevojiteshin për të hartuar një plan strategjik.

Shkurtesat

NVM	Ndermarrjet e vogla dhe te mesme
ZHEL	Zhvillimi ekonomik lokal
BPV	Pruto produkti vendore.
IB	Inkubatori i biznesit
BE	Bashkimi evropian
MTI	Ministria e tregtise dhe Industrise
ARBK	Agjencia per Regjistrimin e bizneseve ne Kosove
MBP	Ministri e Bujqesise dhe Pylltarise
PZHL	Plani Zhvillimor Komunal
FMN	Fondi Monetar Nderkombetare
TVSH	Tatimi Mbi Vleren e Shtuar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
AKM	Agjencia Kosovare e Mirebesimit
AKP	Agjenci Kosovare e Privatizimit
NP	Ndermarrjet publike
BB	Banka Boterore
BERZH	Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim
OBT	Organizata Boterore e Tregtise
ABV	Akti per Bizneset e Vogla
PTT	Post telekomi dhe telekomunikacioni

Hyrje

Një ndër problemet në të cilat po përballen sot shtetet në Evropë apo shtetet në tranzicion por edhe në vendin tonë (Kosovë), është krijimi i një mjedisi të përshtatshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), me qëllim të transformimit të shoqërisë në ekonomi të tregut. Qëllimi kryesor i transformimit politik dhe ekonomik, sidomos tek shtetet në tranzicion është krijimi i sektorit privat, zhvillimi i sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve). Sot në Evropë dhe kudo NVM-të, janë faktorë kryesorë të rritjes së ekonomisë globale. Në Evropë NVM-të, kanë rolin kryesorë në rritjen ekonomike dhe me këtë krijimin e vendeve të reja të punës, prandaj shpesh quhen shtylla kryesore e ekonomisë evropiane. Një ndër politikat kryesore të BE-së (OECD, 2014) është edhe mbështetja e politikave për zhvillimin e NVM-ve. Në BE NVM-të, përbëjnë 99% të të gjitha ndërmarrjeve jo financiare dhe 67% të punësimit totalë si dhe gjenerojnë 58% të vlerës së shtuar totale, sipas (raportit KOSME, 2014) (ISLAMI & MULOLLI, 2016).

Nëse i referohemi Kosovës NVM-të përbëjnë pjesën kryesore të ekonomisë së sektorit privat, ku absorbojnë përafërsisht 80% e punësimit. Pavarësisht rëndësisë së NVM-ve në zhvillimin ekonomik të Kosovës, ende ka dobësi të cilat e pengojnë zhvillimin e këtij sektori, në aspektin e punësimit, produktivitetit dhe vlerës së shtuar, andaj zhvillimi i politikave në drejtim të NVM-ve do të thotë rritjen e ekonomisë së vendit. Në shumicën e vendeve në tranzicion, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), kanë bërë barrën më të madhe të transformimit drejtë ekonomisë së lirë të tregut. Si një ndër faktorët e rëndësishëm për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik dhe shoqëror, NVM-të kanë qenë objekt studimi i shumë autorëve dhe hulumtuesve e poashtu edhe institucioneve shtetërore dhe joshetërore. Fatmirësisht edhe në Kosovë hulumtimet sa i përket NVM-ve, datojnë qysh para vitit 1999. Këto hulumtime kryesisht konsistojnë në identifikimin e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e afarizmit të tyre (Murmullaku, Hoxha, & Ukaj, 2014). Me qëllim të mbijetesës dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme është e nevojshme që organet qeveritare qendrore dhe lokale të zhvillojnë një bashkëpunim me donatorët privat dhe publik me qëllim të zhvillimit të një konsulence me qëllim të trajnimit dhe edukimit dhe promovimit e agjensioneve për zhvillimin e ndërmarrjes. Sipas një studimi në Kosovë rritja e NVM-ve, është duke u zvogëluar si pasojë e pengesave mjedisore të biznesit, siq janë, barra tatimore, konkurrenca e pandershme dhe financimi i papërshtatshëm. Sot në Kosovë ekzistojnë disa politika qeveritare për mbështetjen e NVM-së, të cilat disa prej tyre janë funksionale, kurse

disa prej tyre janë themeluar vetem në aspektin juridik mirëpo implementimi i tyre nuk ka filluar, ende në vazhdim do të mundohemi që ti paraqesim mënyrat e mbështetjes së NVM-së nga ana e qeverisë së Kosovës (ISLAMI & MULOLLI, 2016).

Në Kosovë, janë themeluar disa agjensi të cilat merren me mbështetjen dhe lehtësimin e NVM-ve. Disa agjensi të cilat janë në mbështetje të NVM-ve do t'i paraqesim në vijim:

Në vazhdim do ti përshkruajë prioritetet e strategjisë së komunës së Gjilanit, në periudhën 10 vjeçare, 2005 – 2015, dhe dhënies së ideve të reja për hartimin e një strategjie shumë më të suksesshme, reale, duke u bazuar në traditën e zhvillimit ekonomik të komunës sonë dhe trendet e zhvillimit ekonomik sot në botë. Si prioritetet e strategjisë që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal (ZHEL), janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), duke i analizuar dhe krahasuar edhe sektorët tjerë ekonomik, dhe Panairët e ndryshme të organizuar nga ana e komunës. Unë do të orientohej në strategjinë e zhvillimit ekonomik të komunës së Gjilanit, me që edhe temën e kam zgjedhur duke u orientuar vetëm në nivel lokal, komunal.

Në kapitujt që do ti shtjellojë në vijim do ti identifikojë sfidat me të cilat përballet sot ekonomia e komunës, duke stagnuar në shumë fusha apo veprimtari të ndryshme biznesore. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), janë duke u zhvilluar dhe rritur me një tempo të ngadalshëm si pasojë e mos mbështetjes nga ana e nivelit lokal, rrjedhimisht nivelit qendrorë (Kosovë). Gjatë hartimit të kësaj teme në fokus të veçantë do të kemi pikërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) si garant për zhvillimin ekonomik lokal, për atë edhe do ta hulumtojmë këtë fenomen më tutje. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), gjenerojnë numrin më të madhë për hapjen e vendeve të reja të punës. Mandej në vazhdim do të analizojmë edhe lehtësitë fiskale tatimore se si ndikojnë në hapjen dhe zhvillimin e bizneseve nga qeveria e Kosovës rrjedhimisht nga pushteti komunal i Gjilanit. Procesi i Privatizimit në komunën tonë është në përfundim e sipër, duke ngelur vetëm disa parcela apo tokë bujqësore, të cilat priten të privatizohen në të ardhmen. Edhe për këtë sektorë shumë të rëndësishëm, do të bëjmë fjalë në vazhdim të këtij punimi, respektivisht, se si ka ndikuar në zhvillimin ekonomik lokal (ZHEL). Problem kyç në komunë është shkalla e lartë e papunësisë, nga statistikë që i posedon komuna numri i të rinjëve të sapo diplomuar është gjithnjë në rritje, me që zhvillimi ekonomik ka stagnuar ndër vite si në nivel lokal, po ashtu edhe në nivel qendrorë (Kosovë), shumica e tyre duke mos pa ndonjë perspektivë në vendin e vet janë shtyrë të migrojnë jashtë shtetit në kërkim të një jete më të mirë.

Aktualisht në komunë dominojnë këta sektorë ekonomik, si në vijim: Sektori i tregtisë, sektori i prodhimit dhe sektori i shërbimeve. Sa i përket numrit më të madhë për nga ushtrimi i veprimtarisë së tyre, sektori i tregtisë është më i avancuar, pastaj vjen sektori i shërbimeve, ndërsa sektori i prodhimit është më pak i zhvilluar, duke mos stimuluar nga komuna, për sa i përket kushteve më të favorshme për të ushtruar këtë veprimtari biznesore. Inkubatori i biznesit ekziston në kuadër të komunës, por nuk është edhe shumë funksional përshkak të menaxhimit të dobët, në mënyrë që bizneset fillestare të kenë ku të aftësohen për një periudhë të caktuar, pastaj ato të pavarësohen në mënyrë që t'ju hapin rrugë edhe bizneseve tjera e kështu me radhë. Po ashtu edhe sektori i bujqësisë ka qenë dhe është profitabil, por nga neglizhenca e nivelit lokal dhe atij qendrorë siç është Ministria e Bujqësisë dhe pylltarisë, po përballat me probleme të shumta, duke mos subvencionuar fermer të ndryshëm në kultivimin e drithërave të ndryshme, ku nga këto rendimente një numër i tyre të mund të eksportohet edhe në tregun evropian. Në bazë të burimeve minerale, traditës së fortë industriale, rrjedhimisht ndërmarrësisë dhe njohurive të teknologjisë të afërta me të, komuna e Gjilanit, do të funksionojë si qendër e famshme në rajonin e anamoravës. Një politikë adekuate për token dhe paisjet e freskëta apo të reja të rrjetit të komunikacionit, do ti ndihmojë komunës, që të realizojë potencialin e rritjes ekonomike. Një ndër lehtësitë fiskale (tatimore), ekonomike nga ana e nivelit qendrorë (Kosovë), poashtu edhe nga niveli komunal, është për ato bizneset të cilat priten të themelohen në të ardhmen, për të cilat nuk ngarkohen me tatime apo taksa të ndryshme ndaj shtetit, por edhe stimulimi i ndërmarrjeve aktuale, në mënyrë që të kontribuojnë sa më shumë në zhvillimin ekonomik lokal që pastaj të reflekton edhe nivelin vendi. Zhvillimi i hovshëm i tekniko teknologjisë sidomos në dekadën e fundit ka rezultuar që shumë shërbime të lehtësohen lidhur me zhvillimin e bizneseve në komunën e Gjilanit, infrastruktura elektronike e instaluar në komunë është duke u përsosë çdo vit në mënyrë që çdo qytetari t'ua lehtësojë qasjen në aplikimin dhe marrjen e dokumenteve të ndryshme për të cilën ata e shohin si të nevojshëm. Nga e gjithë kjo që është përmendur më lartë ne do të shtjellojmë në kapitujt vijues më gjerësisht, duke i analizuar dhe krahasuar edhe me qytetet tjera, por që si qëllim apo synim i imi mbetet zhvillimi ekonomik i komunës së Gjilanit, me këtë problematikë do të merrem edhe në të ardhme.

KAPITULLI I

1.1 STRATEGJIA PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS SË GJILANIT NË PERIUDHËN 2005 – 2015?

Si prioritetet e strategjisë për zhvillimi ekonomik lokal, të komunës së Gjilanit, mendojë se janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të). Ekonomia e komunës së Gjilanit kryesisht përbëhet nga sektori privat, Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), ndahen në disa sektorë si në vijim: Sektori i tregtisë, sektori i shërbimeve, sektori i prodhimit, sektori i bujqësisë e kështu me radhë. Sektori privat ka marrë hov pas vitit 1990 e këndej, deri në vitin 2005, janë themeluar disa ndërmarrje të ndryshme dhe që sot e tutje kanë patur progres nga viti në vit dhe janë treguar të suksesshëm sa i përket veprimtarisë në të cilën e ushtrojnë, të të bërit biznes dhe kanë gjeneruar vende të reja pune. Sektori i tregtisë dominon në komunë, për nga numri i themelimit të ndërmarrjeve dhe për nga ulja e shkallës së papunësisë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Sektori i shërbimeve është zhvilluar hovshëm pas vitit 1999, por mendojë se edhe ky sektorë ka shënuar progres, sa i përket të të bërit biznes në komunën e Gjilanit.

Sektori i prodhimit është sektori i cili duhet të stimulohet, si nga ana e niveli lokal, respektivisht komuna e Gjilanit, poashtu edhe nga ana e nivelit qendror, rrjedhimisht Qeveria e Kosovës. Ndërmarrjet prodhuese përbëjnë pjesën kryesore të zhvillimit ekonomik lokal, mandej ky sektorë duhet të jetë fokusi kryesorë i komunës, pasi që këto ndërmarrje absorbojnë me gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe me normën e uljes së papunësisë në komunë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005). Ekonomia e Gjilanit, deri në vitin 1990 ka qenë relativisht stabile, si rezultat i disa Industrive që janë në këtë komunë, ku kanë punësuar një numër të mjaftueshëm të banorëve të kësaj ane (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005). Por nga viti 1990 e tutje kur shqiptarët kanë qenë të privuar nga puna, edhe në komunën e Gjilanit si në të gjithë Kosovën, numri i të punësuarëve të ndryshëm në këto Industri, filloi gradualisht të bie, dukshëm me një mesatare të lartë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005). Mandej pas vitit 1990, filloi sektori privat të merr hapa drejt themelimit dhe zhvillimit nga viti në vit, e deri më sot duke punësuar një numër të konsiderueshëm të kësaj ane. Por përsëri mbetet problem shkalla e lartë e papunësisë, si në nivel lokal komunal, poashtu edhe në nivel qendrorë (Kosovë) (Osmani, Mahmuti, Hyseni,

& Ismajli, 2005). Si pasojë e stagnimit të shumë ndërmarrjeve prodhuese, pas privatizimit, disa prej tyre edhe kanë bankrotuarë apo janë mbyllur si shkak i mos stimulimit nga pushteti burokratik.

Në komunë por edhe në nivel qendrorë (Kosovë), këto ndërmarrje kanë qenë bartëse të zhvillimit ekonomik lokal.

Sektori i bujqësisë po përballët me probleme të shumta si pasojë e diskriminimit dhe mos stimulimit si nga ana e niveli lokal, poashtu edhe nga ana e nivelit qendrorë. Bujqësia si degë e ekonomisë mendojë se është prioritet për zhvillim ekonomik lokal, ky sektorë duhet të subvencionohet në masë të madhe nga niveli qendrorë siq është në këtë rast Ministria e Bujqësisë. Komuna e Gjilanit ka infrastrukture të mire sa i përket zhvillimit të bujqësisë, duke stimuluar sa më shumë fermerë në kultivimin e produkteve bujqësore, që nga ato produkte të kultivuara disa prej tyre të eksportohen edhe në tregun evropian (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Si prioritet i strategjisë në komunë është edhe Arsimi apo niveli Arsimor, të cilës duhet ti kushtohet rëndësi të veçantë, në arsimimin e popullatës së kësaj ane, me që kjo sferë përbën pjesën kryesore sa i përket ngritjes profesionale, ku si rezultat i zhvillimit të arsimit, në të ardhmen të dalin kuadro sa më të suksesshëm të profileve të ndryshme. Megjithëse nga viti 2005 e tutje, komuna e Gjilanit është përballur me numrin e madhë të nxënësve që vijojnë mësimin në këtë komunë, në tri ndërrime, si pasojë që në të ardhmen të ndërtohen sa më shumë shkolla që të eliminohet ndërrimi i tretë. Pastaj tani në komunën e Gjilanit nga ana donatorëve të ndryshëm kanë investuar dhe janë ndërtuar edhe disa shkolla duke eliminuar ndërrimin e tretë, si shkak i mos efektivitetit të tijë. Tash e tutje shkollat punojnë në dy ndërrime, paradipte dhe pas dite (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Strategjia për zhvillim ekonomik lokal (ZHEL) e komunes së Gjilanit, 2005-2007, është rezultuar nga projekti DELTA II. Komuna e Gjilanit është zgjedhur në këtë projekt së bashku me katër komunat e tjera të Kosovës. DELTA II është bashkëfinancuar nga instituti për shoqëri të hapur, (OSI) në Budapest, përderisa vetë komunat pjesëmarrëse në këtë projekt dhe “Friedrich Ebert Stiftung” (FES) kanë dhënë kontribut financiar në një masë me të vogël. Banka Botërore në Washington mbështeti këtë projekt duke i ofruar asistencë teknike (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Ky projekt është implementuar nga instituti për hulumtime zhvillimore “RIINVEST” , në Prishtinë. Synimi i këtij projekti është aftësimi i komunave në krijimin e kushteve me të favorshme për zhvillim dhe rritje të ndermarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve).

Përveq këtij synimi, DELTA II ka edhe disa objektiva tjera, si forcimin e kapaciteteve të administratës komunale që të hartojë dhe implementojë strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal (ZHEL), mbështetja e komunave për të krijuar kushte me të favorshme, për zhvillimin dhe rritjen e ndermarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), dhe forcimin e partneritetit ndërmjet qeverisë komunale, komuniteteve biznesore dhe shoqërisë civile. Kjo strategji përmban vizionin, synimet, objektivat, programet dhe projektet të cilat janë të lidhura dhe të harmonizuara njera me tjetrën (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Si është hartuar strategjia për zhvillim ekonomik lokal (ZHEL)? Në fillim të procesit për hartimin e një strategjie sa më optimale, është formuar ekipi komunal, i ashtuquajtur i grupi i ekspertëve, për zhvillim ekonomik lokal, ku nga është themeluar forumi i palëve të interesuara. Ekipi për zhvillim ekonomik lokal (ZHEL), si grup i ekspertëve, kanë marrë mbështetje politike nga udhëheqësit komunalë. Gjatë hartimit të kësaj strategjie janë organizuar katër punëtori (workshops), në të cilat ekipi i ekspertëve për ZHEL, të komunës së Gjilanit ka marrë pjesë aktivë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Pas qdo punëtorie janë përgatitur plan veprimet, të cilët kanë shërbyer si udhërrëfyes për grupin e ekspertëve komunale të zhvillimit ekonomik lokal, që të zhvillojnë aktivitetet për hartimin e strategjisë. Ekipi i ekspertëve komunalë për ZHEL, mori pjesë në vizitën studiu në Slloveni, nga data 26 shtator deri më 2 tetor 2004, në të cilën janë informuar, lidhur me përvojat sllovene në fushën e ZHEL-it, administratën lokale, hartimin e strategjive zhvillimore, inkubatorët e biznesit, parqet industriale, zonat e lira ekonomike etj (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005). Në fillim të procesit për hartimin e strategjisë, pas marrjes së mbështetjes politike nga kryetari i atëhershëm i kuvendit komunal të Gjilanit, z.Lutfi Haziri, nënkryetari i atëhershëm dhe tani kryetar i kuvendit komunal të Gjilanit, z.Xhemajl Hyseni, si dhe nga kryeshefi ekzekutiv, z.Enver Muji, është formuar grupi i ngushtë, i ashtuquajtur si ekipi i ekspertëve komunalë për zhvillim ekonomik lokal (ZHEL), të komunës së Gjilanit. Ky grup përfaqësonë ekipin kyq të procesit për hartimin e strategjisë. Zyra komunale e ZHEL-it, është vendosur në zyrën për projekte të komunës dhe është në kontakt të rregullt me kryeshefin dhe e informon atë rreth procesit (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Roli i grupit të ekspertëve komunal për zhvillimi ekonomik lokal (ZHEL), është të kordinojë të gjithë aktivitetet e procesit për hartimin e strategjisë. Përveq grupit të ekspertëve komunalë për ZHEL, gjithashtu janë formuar edhe ekipet punuese komunale, të cilët përbëhen nga zyrtarët e drejtorateve të qeverisë komunale. Këto ekipe mbështesin grupin e ZHEL-it, gjatë tërë procesit për hartimin e strategjisë, duke grumbulluar të dhëna, këshilla dhe shqyrtim të drafteve të strategjisë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Ekipet punuese komunale:

- Grupi për ndermarrje ekonomike dhe bujqësi
- Grupi për planifikim dhe shërbime publike
- Grupi për shoqëri civile dhe komunitete
- Grupi për bashkëpunim nderkomunal dhe nderkufitar
- Grupi për shëndetsi, arsim, kulturë, rini dhe sport.

Përveq ekipeve punuese, është formuar edhe forumi i palëve të interesuarë. Antarë të këtij forumi janë palë të ndryshme komunale, si nga administrata, kuvendi, biznesi dhe shoqëria civile. Forumi kontribuoi, duke ju dhënë sugjerime dhe analiza të fazave të ndryshme për hartimin e strategjisë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).


Struktura komunale

Qeverisja komunale e Gjilanit përbëhet nga:

- Kryetari i Komunës
- Nënkryetari i Komunës
- Kryeshefi ekzekutiv, dhe nga 11 drejtori të cilat do të përmendim në vazhdim
- Drejtoria e administratës publike
- Drejtoria për kulturë rini dhe sport
- Drejtori për Buxhet dhe Financa
- Drejtoria për arsim
- Drejtoria për urbanizëm, rindërtim dhe ambient,
- Drejtoria për shërbime publike
- Drejtoria për zhvillim ekonomik
- Drejtori për shëndetsi dhe qështje sociale
- Drejtoria për siguri dhe emergjencë
- Drejtoria për kadastër dhe gjeodezi

- Drejtoria për bujqësi dhe pylltari (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Organogrami i komunës së Gjilanit



Burimi: Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal (2005 – 2007), Organogrami i Komunës .

Të gjithë këto drejtori të cilat janë pjesë përbërëse të komunës së Gjilanit, duhet të kryejnë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, që bien mbi to me përpikëri, në mënyrë që t'i alokojnë resurset për zhvillimin ekonomik lokalë.

Komuna e Gjilanit është qeverisur sipas rregullorës së UNMIK-ut 2000/45, e cila qartazi definon përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë. Mirëpo, ekzistojnë disa ligje dhe rregullore të tjera që janë miratuar nga pushteti qendrorë, në fushën e shërbimeve të kompanive publike, shërbimit civil të Kosovës, arsimit fillor dhe të mesëm, menaxhimit të tokës komunale dhe shoqërore, ku nga problematika e fundit rrjedh nga fakti ngase në të kaluarën, në shumë raste, dallimi ndërmjet tokës që është pronë komunale dhe shoqërore nuk ka qenë i qartë (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

Përgjegjësitë e qeverisë komunale në Kosovë që kanë qenë sipas rregullorës së UNMIK-ut, 2000/45, janë:

- Sigurimi i kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik
- Planifikimi urban dhe ruralë në shfrytëzim të tokës
- Licencimi i ndërtimeve për zhvillime të tjera
- Mbrojtja lokale e ambientit
- Implementimi i rregulloreve për ndërtim dhe standardeve për kontrollë të ambientit
- Sigurimi i shërbimeve lokalë publike dhe të infrastrukturës, duke përfshirë edhe furnizimin me ujë, kanalizimet dhe drenazhet, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave për nxemje lokale
- Shërbimet publike duke përfshirë edhe zjarrfikësit dhe shërbimet emergjente
- Menaxhimin e pronës komunale
- Arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm
- Perkuajdesjen primare shëndetsore
- Shërbimet sociale dhe të banimit
- Mbrojtjen e konsumatorve dhe shëndetit publik
- Licencimin e shërbimeve, duke përfshirë artimin, ushqimin, tregjet, transportin lokal publikë dhe taksitë, gjuetinë dhe peshkatarinë, si dhe restaurantet dhe hotelet
- Panairët dhe tregjet
- Emërimin dhe rrimërimin e rrugëve, lagjeve dhe vendeve të tjera publike
- Sigurimin dhe mirmbajtjen e parqeve publike dhe hapësirave të hapura dhe varrezave.

Aktivitetet tjera që janë të domosdoshme për administrim adekuat të komunës dhe të cilët nuk janë të përcaktuara me ligj (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

1.2 SWOT analiza (Përparësitë, dobësitë, mundësitë, rreziqet)

Në vazhdim do të analizojmë SWOT analizën apo analizën konkurruese SWOT,

Përparësitë	Dobësitë
▪ Popullatë e re dhe e edukuar ▪ Traditë e fortë ndërmarrëse ▪ Kushte të favorshme për zhvillim të bujqësisë ▪ Ujëra minerale ▪ Komunë ndërkufitare ▪ Toleranca ndëretnike dhe siguria ▪ Qendra rajonale didaktike ▪ Qendra aftësuese riaftësuese	▪ Financimi i dobët për biznese nga burimet e jashtme ▪ Bashkëpunimi i dobët ndërmjet komunës dhe bizneseve ▪ Strukturë e dobët organizuese e komunitetit biznesor ▪ Mungesa e strategjisë ekonomike ▪ Mungesa e planit urban komunal ▪ Të dhëna të vjetra mbitokësore kadastrale ▪ Mosekzistimi i kadastrit nëntokësor ▪ Sistemi i vjetruar i ujësjellësit dhe kanalizimit ▪ Infrastruktura e pamjaftueshme shkollore ▪ Mungesa e të dhënave mbi popullsinë dhe ekonominë familjare
Mundësitë	Rreziqet
▪ Investimet nga diaspora ▪ Bashkëpunimi ndërkomunal ▪ Bashkëpunimi ndërkufitar ▪ Investimet e huaja ▪ Fondet trajnuese nga donatorët ndërkombëtar	▪ Statusi i pazgjidhur politik i Kosovës ▪ Tërmetet ▪ Procesi i ngadalshëm i privatizimit ▪ Mungesa e mbështetjes institucionale të bujqësisë ▪ Destabilizimi social si rezultat i rritjes

▪ Krijimi i qendrës seizmike	së papunësisë ▪ Migrimi i të rinjve jashtë vendit
------------------------------	--

Nga ku edhe kemi ardhë në përfundim se komuna e Gjilanit sipas SWOT analizës, së lartë shënuar, në katrorin e dobësive dhe rreziqeve, mandej ajo duhet ti permirësojë këta faktorë dhe në të ardhmen në mënyrë që të rritë zhvillimin ekonomik lokal (ZHEL), rrjedhimisht të gjenerojë vende të reja pune dhe të ulë shkallën e papunësisë në nivel lokal, pastaj ajo do të rezultojë edhe në nivel qendrorë (Kosovë) (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005). Sqarim

Sidoqofte mund te konstatojme se ekonomia e komunes se Gjilanit vazhdimisht eshte e ballafaquar me probleme te shumta te shpenzimeve te mirembajtjes investicionale dhe me shkalle te ulet te akumulimit, sa i perket punesimit i cili ka stagnuar me vite dhe me probleme te transformimit te prones. Pikerisht orinetimi kryesor permanent ngelet, zhvillimi ekonomik lokal (ZHEL), rrjedhimisht nepermes procesit te privatizimit, zhvillimi i ndermarrjeve te vogla dhe te mesme, realizimi i projekteve te reja dhe krijimi i kushteve per nje ambient te shendoshe dhe te sigurt, per thitjen e kapitalit te jashtem dhe nxitjen e ndermarrjeve te vogla dhe te mesme (NVM-ve), vendore ne veprimtari prodhuese (komunale, 2007).

1.3 Vizioni parimet dhe caqet për të ardhmen e komunës

Deklarata e Vizionit

Duke shfrytëzuar pozitën qendrore komuna e Gjilanit do të ketë qeverisje efëiente lokale, me infrastrukturë të rregulluar, urbane dhe rurale, në trekëndëshin e dyfishtë do të bëhet një urë moderne ndërlidhëse, do të ofrojë shërbime cilësore në një mjedis të qëndrueshëm, edukim dinamik me teknologji moderne që mbështetet në zhvillimin dhe rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), në gjenerimin e vendeve të reja të punës dhe në fokus në bujqësi në partneritet të plotë, identitetin do ta fuqizojë në vlerat e veta e sidomos ato kulturore e qytetare, si një qendër regjionale universitare (komunale, 2007).

Plani zhvillimor lokal (PZHL), i komunës së Gjilanit, është duke e përgatitur të ardhmen për 15 vitet e ardhshme dhe më tej. Për këtë periudhë kohore, vizioni, parimet dhe qëllimet, në vijim do ta udhëzojnë zhvillimin e komunës.

Vizioni i komunës së Gjilanit i vendos rrotullimet e mësipërme përth parimeve dhe qëllimeve të zhvillimit në vijim:

- ✓ Paisjet e një infrastrukture adekuate sociale dhe teknike, e cila i mbeshtet nevojat e banorëve,
- ✓ Promovimin e ekonomisë së qëndrueshme të komunës, duke siguruar punë të mjaftueshme për banorët e qytetit,
- ✓ Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit socio-ekonomik më të balancuar, të rajonit dhe përmirësimit të konkurrencës,
- ✓ Inkurajimi i zhvillimit të gjeneruar nga funksionet urbane dhe përmirësimi i raportit ndërmjet qytetit dhe fshatit,
- ✓ Ngritjen e kushteve të shëndetshme, të banueshme dhe atraktive në zonat urbane dhe në zonat e fshatrave,
- ✓ Furnizimin e mjedisit urban dhe fshatar të mjaftueshëm, duke kontribuar në përmirësimin e kualitetit të jetës në rrethinë,
- ✓ Mundësimi në çasje në informata dhe njohuri,
- ✓ Zvogëlimi i dëmeve mjedisore,
- ✓ Përparimi dhe mbrojtja e resurseve dhe të trashëgimisë natyrore,
- ✓ Promovimin e infrastrukturës për rekreacion dhe turizëm (komunale, 2007).

Zhvillimin e një sistemi për trafik të përshtatshëm, të transportit të lëvizshëm, duke siguruar qasje të mirë urbane.

Qëllimi i analizës situacionale (aktuale), nuk është vetëm gjetja e problemeve për ti përmirësuar ato, për më shumë gjetja e forcës së komunës. Komuna ka burime të limituara (kufizuara), në dispozicion. Megjithatë është e rëndësishme që këto burime të përqëndrohen apo të orientohen në sektorët, të cilët po e bëjnë Gjilanin të dallueshëm, nga pjesët tjera të Kosovës, dhe të cilët posedojnë potencial që të zhvillojnë komunën ekonomikisht më tutje (komunale, 2007).

1.4 Objektivat dhe synimet

Në bazë të burimeve minerale, traditës së fortë industriale, rrjedhimisht ndërmarrësisë dhe njohurive të teknologjisë të afërta me të, Gjilani do të funksionojë si qendër e famshme në rajonin e anamoravës. Një politikë adekuate për token dhe paisjet e freskëta apo të reja, të rrjetit të komunikacionit, do ti ndihmojë komunës së Gjilanit që të realizojë potencialin e rritjes për ekonominë e ardhshme e cila do të zhvillohet nga sektori i tregtisë, shërbimeve dhe

prodhimeve. Për të synuar këtë qëllim, komuna e Gjilanit duhet të ketë shfrytëzim sa më të mirë, duke bashkëpunuar me Shtetet fqinje, siç janë: Serbia, Maqedonia, Shqipëria dhe Mali i zi, dhe lidhjet e tij, të mira tradicionale që i posedon me qytetet e Bujanovcit, Preshevës, (në Serbi) dhe Kumanovës (në Maqedoni) (komunale, 2007).

Synimet për zhvillim afatgjatë janë:

- Zhvillimi hapësinorë i planifikuar dhe kontrolluar,
- Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës rrugore dhe krijimi i asaj hekurudhore, në nivel regional,
- Përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës sociale dhe teknike si dhe ofrimi sa më i mirë i shërbimeve publike,
- Rregullimi dhe formalizimi i vendbanimeve joformale,
- Sigurimi i qasjes në hapësira adekuate për banim për secilin qytetarë,
- Aplikimi i politikave që të stimulojë zhvillimin e zonave rurale,
- Mbrojtja e tokës bujqësore,
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore,
- Shfrytëzimi sa më racional i resurseve,
- Ulja e shkallës së papunsisë dhe varfërisë, në nivel komunal,
- Kontrollimi më i sigurt i zonave të rrezikuara nga katastrofat, natyrore dhe të shkaktuara (komunale, 2007).

1.5 Prioritetet strategjike

- Hartimi i planeve rregulluese të qendrave sekondare,
- Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore,
- Mbrojtja e mjedisit,
- Ofrimi i infrastrukturës së domosdoshme për krijimin e kushteve për investime në zhvillimin ekonomik,
- Shfrytëzimi racional i territorit,
- Hartimi i programit për trajtimin e vendbanimeve joformale,
- Avancimi i projekteve ndërkufitare,
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore,
- Përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe teknike (komunale, 2007).

Tokat ndërmjet fshatrave kryesisht do të përdoren për bujqësi, si prioritet janë paraparë, bujqësia nga toka e lëvruar dhe rritja e kafshëve shtëpiake, por gjithashtu edhe mënyra tjera të

bujqësisë, të cilët do të ndihmojnë në ruajtjen e pejsazhit kulturor në rrafshinë, p.sh. toka për kullota dhe pemëtaria. Mandej përdorime të tjera të tokës bujqësore janë parapa vetëm në raste të veçanta (komunale, 2007).

Duke e pa këtë dendësi të madhe të popullsisë, të cilët pas vitit 1999, janë shpërngulur prej zonave rurale në zona urbane dhe duke analizuar mundësitë që në të ardhmen transporti publik hekurudhorë të ndërtohet edhe në komunën e Gjilanit, me që është profitabile dhe të ua lehtësojë banorëve të komunës qasjen edhe me qytete tjera (komunale, 2007).

Veprimet e nevojshme për përmirësimin e mobilitetit:

- Rregullimi i transportit publik dhe masave të sigurisë në komunikacion,
- Transporti i ri publik, autobus – tren,
- Lidhje të mira ndër rajonale,
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrugëve në zonat rurale,
- Shtigjet për këmbësorë dhe çiklistë dhe
- Rregullimi i trotuarëve dhe udhëkryqeve (komunale, 2007).

Përmirësimi i infrastrukturës duhet të planifikohet të bëhet edhe me shtetet fqinje në mënyrë që komuna të ketë më lehtë të bashkëpunojë me to, në mënyrë që në të ardhmen të ketë zhvillim reciprok ekonomik, sa i përket të të bërit biznes por edhe në fushëveprimtari tjera që janë në interes të dy shteteve. Ne në vazhdim do ti përmendim disa rrugë që mendojmë se janë prioritetet strategjike për të ardhmen e komunës së Gjilanit, si në vijim,

- ✓ Përmirësimi i kualiteti fizik dhe zgjerimi i rrjetit rrugorë në drejtim të Maqedonisë dhe Serbisë,
- ✓ Zgjerimi i rrugës në drejtim të Preshevës dhe trasimi i rrugës dhe asfaltimi përmes fshatit Zhegër veq është ndërtuar para disa viteve por pritët të hapet në një të ardhme të afërt si rrugë ndërkombëtare që lidhë qytetin e Gjilanit me qytetin e Kumanovës në Maqedoni (komunale, 2007).

KAPITULLI II

2.1 Lehtësitë fiskale, ekonomike të të bërit biznes në komunën e Gjilanit, hapja dhe zhvillimi i tyre, nga qeveria qendrore e Kosovës dhe nga pushteti Komunal?

Si lehtësi fiskale, tatimore, ekonomike, nga ana e qeveria e Kosovës kishte me qenë subvencionimi me grande apo subvencione duke e aplikuar grejs periudhën, sidomos për bizneset prodhuese, deri sa të kthehet investimi i bërë, ndërsa për bizneset fillestare që pritet të themelohen në të ardhmen, të iu mundësohet lirimi nga barrierat tatimore për një periudhë të caktuar, që t'iu ipet hapësirë që të zhvillojnë aktivitetin e tyre afarist duke mos hyrë në obligime shtetërore, ku pastaj, të mundë të gjenerojnë sa më shumë vende të reja pune, dhe ti alokojnë resurset drejtë zhvillimit dhe rritjes (komunale, 2007). Kjo është sa i përket nga ana e nivelit qëndrorë (Kosovë). Por me këto lehtësira duhet vepruar edhe niveli lokal, rrjedhimisht komuna e Gjilanit, duke iu ofruar qdo mundësi lehtësuese që të krijohen sa më shumë biznese e veçanërisht në fokus ato prodhuese, në mënyrë që të ndikojnë në zhvillimin ekonomik, duke reflektuar edhe në uljen e normës së papunësisë në nivel lokal. Në Kosovë ekzistojnë disa agjenci që i mbështetin bizneset, duke ua lehtësuar afarizmin apo mënyrën e të bërit biznes, me disa lehtësira, pastaj atyre të iu ofrohet më shumë mundësi, apo si stimulim që në të ardhmen të zhvillohen dhe rriten me një tempo më të shpejtë, në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal, respektivisht në nivel qëndrorë (Kosovë) (komunale, 2007). Me gjithëse Kosova ka një trend të rritjes së bizneseve pas vitit 1999, rrjedhimisht nga këto biznese aktuale por edhe nga ato që priten të themelohen në të ardhmen presim që të shëndrrohen në biznes engjujë apo në biznese gjigande. Në Komunën tonë, por edhe në vend siq është Kosova, egzistojnë disa biznese të ndryshme, kryesishtë, në këta sektorë: tregtare, shërbyese dhe prodhuese, ku nga këto biznese të përmendura ato tregtare dominojnë për nga numri i madhësisë së tyre, ngase investimi në këtë llojë biznesi është më pak i kushtueshëm, sa i përket për nga dallimi i atyre sektorëve tjerë. Sektori i shërbimeve ka filluar të zhvillohet dhe të rritet, por sektori i prodhimit ka stagnuar nën një mesatare ose është fundosur nën te.

Bazuar në definicionin e politikave fiskale, ato nënkuptojnë përdorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me qëllimet dhe objektivat e politikës ekonomike. Nga kjo del se politikat e mirëfillta fiskale nënkuptojnë prioritetin e qeverisë për të planifikuar me kujdes

çdo taksë dhe tatim që parashohin politikat ekonomike qeveritare në mënyrë që të kemi të hyra të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet publike apo të dalat publike.

Mendoj që Kosova po ballafaqohet me tri sfida kryesore sa i përket hartimit të politikave fiskale si njëri nga nënsistemet më të rëndësishme të politikave ekonomike të shtetit (Tolaj, 2015).

1.Harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së

Një nga sfidat kryesore që politikat fiskale janë duke u përballur në periudha të ndryshme të zhvillimit të shtetit është harmonizimi i legjislacionit vendor me legjislacionin e BE-së lidhur me politikat fiskale. Si ligje bazike në fushën e rregullimit të politikave fiskale në Kosovë janë:a) Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;b)Ligji për Tatimin në të Ardhurat Personale dhe c) Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Shteti ynë sa i përket legjislacionit në këtë fushë ka përafrim me atë të BE-së,por problemi qendron te zbatimi në praktikë i këtyre ligjeve dhe akteve tjera nënligjore sa i përket politikave fiskale,ku shpeshherë është treguar joprofesionalizem dhe ndërhyrje nga më të ndryshmet (Tolaj, 2015).

Veprimet e pamatura dhe të paanalizuara mirë në aspektin fiskal nga ana e institucioneve qeveritare ka bërë që në Kosovë të kemi evazion fiskal, pasiguri financiare, pakënaqësi buxhetore me tendencë të trazirave sociale. Politikat fiskale duhet të hartohen duke zhvilluar konsultime dhe ujdj edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) (Tolaj, 2015).

2.Kosova duhet të zhvillojë një sistem modern tatimor

Procesi i zhvillimit buxhetor duhet të ketë parasysh respektimin e rregullës fiskale ku deficit i përgjithshëm buxhetor nuk duhet të kalojë 2 % te Bruto Produktit Vendor (BPV).Andaj profesionistët gjatë hartimit të politikave fiskale duhet të kenë si prioritet ruajtjen e deficitit të

ulët buxhetor,nivelin e qëndrueshëm të borxhit publik të vendit,ngarkesës së ulët të biznesit me tatime (Tolaj, 2015).

Kosova duhet të zhvillojë një sistem të thjeshtë dhe modern tatimor. Një shtet stabil dhe funksional nuk mund të mendohet pa zbatim të mirëfilltë të instrumenteve të politikave fiskale. Në vendin tonë si instrumente janë tatimet, taksat, huatë publike,kontributet e tjerë. Të hyrat fiskale në Kosovë janë të koncentruara në buxhetin e shtetit. Fokusi kryesor duhet të jetë në rritjen e nivelit të grumbullimit të të hyrave brenda vendit në raport me ato që arkëtohen në kufi (Tolaj, 2015).

Pra duhet të bëhet zgjerimi i bazës taimore. Në funksion të relizimit të këtij qëllimi duhet të avancohet lufta ndaj ekonomisë joformale dhe pastrimit të parasë. Parandalimi dhe luftimi i suksesshëm i ekonomisë jo formale në të njëjtën kohë do të sigurojë ruajtjen e ekuilibrit fiskal në mes të nevojave për financimin e sektorit publik dhe nevojës së zhvillimit të sektorit privat,duke krijuar kushte të barabarta për zhvillimin e sektorit privat (Tolaj, 2015).

3.Decentralizimi i politikave fiskale

Njëra nga sfidat e qeverisjes me politikat fiskale është decentralizimi i politikave fiskale.Sa më shumë që kemi dekoncentrim të politikave fiskale dhe financiare aq më shumë kemi mundësi të aplikimit të drejtë dhe të sigurt të parasë publike. Decentralizimi fiskal nënkupton sigurimin e mjeteve financiare për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe autorizimi i komunave që vet të marrin vendim për mënyren e shfrytëzimit të këtyre mjeteve, me qëllim të përmbushjes se objektivave të planifikuara (Tolaj, 2015).

Me decentralizim fiskal fitojnë të gjithë akterët institucional si në nivel lokal e poashtu edhe në nivel qendror,sepse pushteti qendror lirohet nga procedurat e tepërt lidhur me planifikimin për mbledhjen e të hyrave dhe planin për destinimin e shpenzimeve dhe poashtu nga kjo përfitojnë edhe komunat sepse të gjitha taksat dhe tatimet që realizohen në nivel lokal destinohen për tu shpenzuar në nivel lokal (Tolaj, 2015).

Në Kosovë komunat kanë pavarësi financiare sa i përket tatimeve dhe taksave si dhe të hyrave tjera,pasi që këtë e rregullojnë dy ligje:a)Ligji për financat e pushtetit lokal dhe b)Ligji për tatimin në pronë (Tolaj, 2015).

Mirëpo aplikimi i këtyre dispozitave ligjore nuk është duke u bërë në mënyrë adekuate dhe shpesh herë me ndërhyrje duke bërë shpërndarjen e buxhetit të shtetit nëpër rajone dhe komuna të cilat i sjellin të hyra më pak shtetit. Andaj kjo politikë jobalancuese fiskale ka pasur ndikim të drejtpërdrejt në jostabilitetin financiar dhe fiskal të vendit. Nga kjo përpos tjerash kemi edhe shkelje të parimit të demokracisë, sepse parimisht ai që paguan më shumë taksa dhe tatime duhet të merr më shumë të hyra buxhetore (Tolaj, 2015).

Si përfundim mund të themi se që Kosova të ketë një rritje të qëndrueshme ekonomike, duhet që institucionet qeveritare të kanë prioritet konsumin privat, investimet private dhe eksportin. E gjithë pritshmëria sa i përket strukturës ekonomike të Kosovës në të ardhmen është se ajo do të dominohet nga rritja e produktivitetit në bujqësi, e shoqëruar me investime më të mëdha në industri të lehtë dhe prodhim (Tolaj, 2015).

Mund të vijmë në konkluzionin e përgjithshëm se politikat fiskale në Kosovë është e domosdoshme që të reformohen dhe ndryshohen, mirëpo duhet pasur kujdes që çdo ndryshim duhet bëhet me profesionalizëm dhe në përputhshmëri me standardin jetësor dhe atë të zhvillimit ekonomik të vendit, pasi që në të kundërtën kjo reflekton negativisht në jetën e qytetarëve (Tolaj, 2015).

Me qëllim të zbatimit të reformave fiskale, Ministri i Financave Bedri Hamza përveç që ka sjellur në fuqi vendimet për lirim nga tatimi doganor dhe akciza për lëndën e parë, gjysmë produktet, linjat e prodhimit, gjithashtu nga java e ardhshme do të lirohen pajisjet e Teknologjisë Informative, për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës (Rajonipress, 2018).

Këtu përfshihen edhe pjesët rezervë për pajisjet e prodhimit si dhe është duke e rishqyrtuar edhe legjislacionin e tatimit në të ardhura personale, të ardhura të korporatës, Ligjin e TVSH-së dhe Ligjin e Administratës dhe Procedurës Tatimore (Rajonipress, 2018).

Përmes rishikimit të legjislacionit, Ministria e Financave pretendon të ndihmojë zhvillimin e sektorit privat, në këtë rast sektorin e prodhimit që të ketë mundësi më të mëdha të zhvillimit.

“Tani do të vazhdojmë me reformën ligjore më të madhe në vendin tonë me Ligjin e tatimit mbi vlerën e shtuar, ku përveç lirimit të lëndës së parë e cila prodhohet në vendin tone, nga tatimi i vlerës së shtuar do të bartet mbledhja e Tatimit të Vlerës së Shtuar nga kufiri në

brendësi të vendit, kjo reformë do të jetë një ndihmë shumë e madhe për biznesin”, thuhet në komunikatën e ministrisë së Financave (Rajonipress, 2018).

Kjo reformë mundëson që bizneset të kenë likuiditet më të madh, biznesi do të ketë mundësinë që të investojë më shumë në zgjerimin e biznesit dhe do të kursehet nga kreditë dhe interesat e ndryshme bankare (Rajonipress, 2018).

2.1.1 Koncepti i politikës fiskale

Politika fiskale konsiston në përdorimin e taksave dhe shpenzimeve qeveritare si mjete për të ndikuar në treguesit makroekonomik të një vendi. Shpenzimet qeveritare ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve në ekonomi, pra edhe në nivelin e GDP-së, e për rrjedhojë edhe në nivelin e punëzënies, inflacionit etj (Sylqa & Kastrati, Politika fiskale dhe reflektimi i saj ne zhvillimin ekonomik, 2013). Politika fiskale ndikonë drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë në ekonominë e një vendi. Vendimet e marra në politikën fiskale nuk janë të lehta, për shkak se ndryshimi i një variabli mund të shkaktojë ndryshim në variablat e tjerë, dhe të merr kahjen e gabuar, prandaj politika fiskale konsiderohet si një fushë komplekse e cila është e nevojshme të analizohet në mënyrë detale. Sistemi fiskal në Kosovë ballafaqohet me ide e sfida nga më të ndryshmet. Pa qëllim të theksimit të ndonjë problemi specifik, Brenda këtij sistemi, disa nga të metat janë mjaft evidente dhe nuk kërkojnë angazhim të theksuar për tu zgjidhur (Sylqa & Kastrati, Politika fiskale dhe reflektimi i saj ne zhvillimin ekonomik, 2013). Të tjerat kërkojnë reforma radikale dhe përmasa gjenerale. Ulja e normave tatimore e bërë nga ana e qeverisë ka qenë hapi më i qëlluar në Kosovën e pasluftës. Vendimi i tillë ka ndihmuar në zhvillimin e bizneseve dhe në shpërndarjen e barrës tatimore tek të gjithë pjesëmarrësit. Pozitiviteti më i lartë vjen nga ulja e tatimit për korporata që ka qenë 20% ndërsa tani është 10%. Kjo e bëri Shtetin shumë më atraktiv në nivel botërorë. Megjithatë në valën e optimizmit mbetet i harruar rritja e TVSH-së nga 15% në 16%. Ndonëse u proklamua si rritje prej vetëm 1%, e vërteta është se TVSH është rritur për një pike të përqindjes dhe kjo është e barabartë me 6.6% (Sylqa & Kastrati, Politika fiskale dhe reflektimi i saj ne zhvillimin ekonomik, 2013).

2.1.3 Ndikimi i reformave ligjore në ambientin afarist në Kosovë

Institucionet vendore gjatë viteve të fundit i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit të ambientit afarist, përmes reformave ligjore, më saktësisht amendamentit të ligjeve në fuqi apo edhe miratimit të ligjeve të reja në pajtim me legjislacionin dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Në këtë drejtim, institucionet përkatëse, përmes reformimit të ligjeve, kanë arritur të shënojnë progresin më të madh të deritanishëm në rangimin e raportit të Bankës Botërore “ Të Bërit Biznes” për vitin 2012, duke u ngritur në pozitë më të lartë.

Në aspektin legjislativ, është amendamentuar Ligji për Shoqëritë Tregtare, duke eliminuar kështu tarifat për regjistrimin e biznesit dhe duke shkurtuar kohën e regjistrimit të tij, në një ditë për biznese individuale dhe tre ditë për biznese të shoqërive aksionare. Gjithashtu, tashmë është integruar çertifikata e numrit fiskal në çertifikatën e regjistrimit, çka nënkupton përgjysmimin e procedurave të mëparshme të regjistrimit të biznesit. Për Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar është eliminuar kapitali themelor i domosdoshëm për regjistrim në vlerë prej 1000 euro, ndërsa shkurtimi i kohës së regjistrimit të biznesit është arritur gjithashtu përmes krijimit të qendrave për regjistrimin e biznesit në nivele komunale, ku bizneset mund të kryejnë të gjitha procedurat e regjistrimit në një vend. Më saktësisht janë hapur 26 qendra “ one stop shop” nëpër komunat e Kosovës, rrjedhimisht edhe në komunën e Gjilanit (Shiroka - Pula, 2013.).

Përmes amendamentit të Ligjit të Ndërtimit, është shkurtuar për rreth 80 % e kohës dhe janë ulur shpenzimet për regjistrimin përkatësisht ndërtimin e një objekti. Gjithashtu, nën Ligjin mbi ndërtimet, procedurat e licencimit janë lehtësuar dhe përllogaritjet e tarifave të ndërtimit bazohen në parimet e rimëkëmbjes së shpenzimeve. Sa i përket tregtisë ndërkufitare, deri tani janë zvogëluar 20% të shpenzimeve tregtare përveç të tjerash, përmes lehtësimit të procedurave. Ndërsa, Doganat e Kosovës janë përfshirë në raportin e zhvillimit të biznesit, si reformë e rëndësishme. Gjithashtu vlenë të theksohet se Doganat e Kosovës kanë zvogëluar numrin e dokumenteve të kërkuara dhe shpenzimet për import dhe eksport. Numri i dokumenteve për eksport ka rënë nga 8 në 2, ndërsa numri i dokumenteve për import është zvogëluar nga 8 në 3 (Shiroka - Pula, 2013.).

Si kryesuese në përmirësimin e rangimit të treguesit Mbrojtja e Investitorëve, Kosova e ka përmirësuar dukshëm mbrojtjen e aksionarëve, duke përmirësuar, ndër të tjera, kërkesat për publikimin e transaksioneve, në rast të konfliktit të interesit në mes të zyrtarëve të korporatave, duke iu mundësuar aksionarëve të mbulojnë dëmet që vijnë si pasojë e transaksionit, si dhe duke iu mundësuar gjykatës ta zhvlerësojë transaksionin, nëse aksionarët e realizojnë kërkesën me sukses (Shiroka - Pula, 2013,).

Organizatat që mbështesin aktivitetin e NVM-ve në Kosovë duhet të zbatojnë politika selektive dhe procedura më të thjeshta gjatë përzgjedhjes së ndërmarrjeve dhe projekteve që do t'i mbështesin, në mënyrë që të motivohen NVM-të për një bashkëpunim të vazhdueshëm me ta dhe që bashkëpunimi i tillë të japë efekte më të mira ekonomike dhe financiare.

Lehtësi tjera fiskale sa i përket nga ana e nivelit qendrorë (Kosovë), që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal, komunal, si dhe hapja e bizneseve është, thjeshtësuar procedura dukshëm në krahasim me vitet përpara, qdo vitë duke u bërë edhe më e lehtë, ku secili individ që planifikon të hapë apo të themelojë, ndonjë biznesë nuk ka nevojë të shkojë në komunë të aplikojë për të, por atë ua mundësonë sistemi online i ofruar nga ana e nivelit qendrorë rrjedhimisht qeveria e Kosovës poashtu edhe nga komuna e Gjilanit, softweri aplikativ i vendosur në uebasjtin e komunës si E – regjistrimi, ku me klikimin në të hynë drejtpërdrejt në procedurat për regjistrimin e biznesit, drejtpërdrejtë në agjencinë e regjistrimeve të biznesit, e njohur si ARBK, që funksionon në kuadër të Ministrisë së tregtisë dhe industrisë (MTI-së), duke ua shkurtuar kohën e humbur për të shkuar në komunë për të marrë aplikacionet në mënyrë manuele, në vijim do të paraqes linkun edhe me foto se si duket i bashkangjitur si vegzë në uebsajtë, të komunës, dhe në uebsajtë të ARBK-së.



REPUBLIKA E KOSOVËS
 MINISTRIA E TREGTISË
 DHE INDUSTRIE



AGJENCIA E REGJISTRIMIT
 TË BIZNESEVE TË KOSOVËS

[Webmail](#) | [Harta e faqes](#) | [Shqip](#) | [English](#) | [Serbian](#)

[Ballina](#)
[Agjencia](#)
[Sektori i Pengut](#)
[Legjislacioni](#)
[Dokumentet](#)
[Raportet](#)
[Media](#)
[Kontakti](#)

Emri i Biznesit

Numri i Biznesit

Numri i Fiskal

ID e Pronarit / Autorizuesit

Aktiviteti Kryesor

Aktivitetet Tjera

Regjistrimi i Biznesit

- > [Llojet e Bizneseve](#)
- > [Regjistrimi i Biznesit të ri](#)
- > [Regjistrimi i ndryshimeve në biznes](#)
- > [Kërkesa për shuarje të biznesit](#)

Rreth Agjencisë

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. ARBK funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash, si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare që realizohet përmes lidhjes ndërmjet 29 qendrave komunale të regjistrimit (me mundësi të shtimit të tyre) të njohura si zgjidhje

e-Shërbimet

Përmes kësaj faqe, të ofruar nga agjencia për regjistrimin e biznesit në Kosovë, (ARBK), mundë të bëhet regjistrimi i bizneseve të ndryshme në mënyrë digjitale, tani të njohura si e-Regjistrimi i Biznesit, e-Regjistrimi i Pengut, ku shihen edhe në foto lart djathtas, të bashkangjitur si vegzë në websajtë të ARBK-së. Këto shërbime të ofruara nga Qeveri e Kosovës, rrjedhimisht, agjencia për regjistrimin e biznesit në Kosovë (ARBK), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së tregtisë dhe Industrisë (MTI), është një lehtësim sa i përket hapjes dhe zhvillimit të biznesit, por edhe nga ana e nivelit lokal, respektivisht komuna e Gjilanit, ka qenë një link, ku secili individ apo person juridik që planifikon me hap ndonjë biznes, komuna ua ka ofruar shërbimet elektronike, përmes websajtit, që e posedon, të hyjë aty dhe të klikojë në linkun e e-regjistrimi, ku pastaj të ketë qasje të drejtpërdrejt në websajt të ARBK-së, kjo është sa i përket sistemit online, të shërbimve, ndërsa sa i përket metodës manuale mundet me e regjistru biznesin edhe duke vajtur në Komunë drejtpërdrejtë te zyrtari ligjor i agjencisë për regjistrimin e biznesit që funksionon në kuadër të Komunës.

2.2 Perdorimi i teknologjise informative per te ofruar sherbimet on-line

Qeverisja elektronike, ne ditet e sotme, eshte nder kriteret baze qe reflekton direkt ne rritjen e efikasitetit ne aspektin e ofrimit te sherbimeve administrative ne raport me qytetaret. Qeverisja elektronike ndikon direkt ne: Rritjen e efektivitetit dhe potencialeve ne menaxhimin financiar; Rritjen e efektivitetit ne menaxhimin e burimeve njerezore, duke krijuar nje ambient transparent: Rritjen e efektivitetit dhe potencialeve ne raportet dhe analizat statistikore; Rritja e transparences ndaj publikut dhe organizmave te ndryshme; Krijimin e nje ambienti per shkembim efikas dhe te shpejte te informacionit me individet, organizma dhe institucione te tjera relevante; Permiresimin e administrimit te sherbimeve publike; Prokurimin elektronik; Pagesen elektronik te tatimeve; Regjistrimin elektronik per bizneset e keshtu me radhe. Ne dhjete vitet e ardhshme Komuna do te kujdeset qe te sponzorizojte legjislacionin ne menyre qe te krijohet baza e mjaftueshme ligjore per perdorimin e teknologjise informative. Aktualisht, infrastruktures ligjore ne Kosove, rrjedhimisht ne Gjilan i mungojne, ligjet bazike qe garantojne perdorimin e sherbimit online, prandaj kompletimi i kesaj baze ligjore gjithashtu eshte nje nder objektivat qe ka per qellim te arrihet, ne menyre qe qytetareve te ju mundesohet qasja on-line ne sherbime duke rritur keshtu efikasitetin e organeve lokale dhe duke rritur mundesite per qytetaret qe te marrin sherbime te shpejta dhe ne qdo kohe (lokal, 2016).

2.2.1 Zhvillimi i politikave efektive per te nxitur pjesemarrjen e qytetareve

Nder parimet kryesore te qeverisjes se mire eshte pjesemarrja qytetare. Ne kete menyre, Komuna duhet te hartojte politika efektive ne menyre qe qytetaret te ushtrojne te drejten e tyre per te shprehur mendimin e tyre ne procesin e marrjes se vendimeve ne lidhje me interesin publik, qofte ne menyre direkte apo indirekte.

Permes procesit te pjesemarrjes qytetare do te krijoheshin parakushtet per te rritur transparencen e punes se organeve komunale qe eshte nje parim tjetër i qeverisjes se mire ne menyre qe te ndertohet besimi reciprok midis qeverive lokale dhe publikut, nepermjet qasjes se garantuar ne informacion dhe qasjes se lehte ne informata te sakta dhe te mjaftueshme (lokal, 2016). Krijimi i politikave efektive per te rritur pjesemarrjen qytetare jane parakushti kryesor per zhvillimin e demokracise lokale te bazuar ne nje vision dhe strategji te qarte, me pjesemarrje te qytetareve ne te gjitha proceset e zhvillimit ne menyre qe ata te fitojne

ndjenjen e pronesise dhe pergjegjesis se perparimin e komues sone. Prandaj, me qellim te arritjes se ketij objektivi komuna duhet te hartoje politika si vijon:

- 1.Politika lokale per nxitjen e aktivizimit qytetar;
- 2.Politika per nxitjen e punes vullnetare te studenteve dhe nxenesve;
- 3.Politika per funksionalizimin e qendrave rinore neper fshatra;
- 4.Politika per funksionalizimin e keshillave te fshatrave;
- 5.Politika per perfshirjen dhe angazhimin e pensionisteve ne jeten publike;
- 6.Politika per angazhimin e personave me aftesi te kufizuara;
- 7.Politika per nxitjen e pjesemarrjes se grave si dhe kategorive sociale te pa-mbrojtura;
- 8.Politika lokale per trajtimin e femijeve te rruges; dhe
- 9.Politika lokale per krijimin e rrjeteve sociale, ekonomike, rinore, te sportit dhe kulturore.

Perveq politikave lokale, komuna duhet te krijojte edhe mekanizmat perkates institucional qe do te adresojne nxitjen e pjesemarrjes se qytetareve ne vendimmarrje dhe ne jeten sociale komunale. Ne vitet e ardhshme komuna duhet te angazhohet te krijojte nje platform per formimin e rrjeteve ne nivelin lokal. Keto rrjete, qofte nga sektori jo-qeveritar, qofte nga fusha e artit, kultures, rinise, sportit apo kategorive te veqanta sociale jane nje element tjeter shume i rendesishem qe nxite pjesemarrjen qytetare. Kjo platforme duhet te jete gjithepershireshe duke perfshire shume aktore qe ka per qellim rritjen e nderveprimit ne mes individeve dhe organizatave nga sfera te ndryshme te qeverisjes, kultures, sigurise, artit, sektorit jo-qeveritar, bizneseve dhe sherben si rruge per krijimin e lidhjeve me rrjetet nder-komunale apo edhe me gjere me rrjetet nderkombetare. Keto rrjete njekohesisht do te kene mundesine e influencimit edhe ne krijimin e politikave te reja lokale duke perfshire ketu edhe procesin e vendimmarrjes ne nivelin lokal (lokal, 2016).

2.2.2 Strategjite e veprimit per arritjen e objektivit strategjik

Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucioneve te komunes per te arritur permiresim te qendrueshem ne sherbimet komunale per qytetaret.

Ne vitet ne vijim me qellim te forcimit te kapaciteteve te Komunave, por edhe te Komunes tone, ne menyre qe te permbushin kerkesat e qytetareve dhe te kete nje permiresim te qendrueshem per sherbimet komunale, do te ndermerren masat dhe veprimet si vijon:

- Krijimi i nje qasje gjithepershires dhe te kordinuar per zhvillimin e kapaciteteve profesionale, sipas nje sistemi te avancuar te edukimit te vazhdueshem profesional per zyrtaret komunal,
- Fasilitimi i ndryshimit te sjelljes se punonjesve te administrates, permes mekanizmave te vleresimit te performances dhe motivimit te zyrtareve komunal,
- Krijimi i strukturave shteterore adekuate per zhvillimin e kapaciteteve, si institucione pergjegjese per zhvillimin e kapaciteteve te zyrtareve komunal,
- Zhvillimi i kapaciteteve te pushtetit lokal dhe institucionalizimi i mekanizmave efektive per te monitoruar punet qe dalin nga partneriteti me shoqerine civile dhe biznesin privat (lokal, 2016).

2.3 Historiku i shkurtër i ekonomisë dhe menaxhmentit?

Sipas rezultateve të regjistrimit të vitit 2011, Komuna e Gjilanit ka 90.015 banorë dhe 17.048 ekonomi familjare, komuna e Gjilanit ka mbi 2 mijë e 100 biznese që funksionojnë dhe zhvillojnë fushë veprimtarinë e tyre, kryesisht biznese të vogëla edhe të mesme, që janë kryesisht tregtare dhe shërbyese. Teritori i komunës mbulon një hapësirë prej 385 km².

Sistemi i mëhershëm i ekonomisë së instaluar në Komunën e Gjilanit është mbështetur në gjigantet dhe sistemet e mëdha industriale pranë sektorit shoqërorë që ka pasur dallim të konsiderueshëm me trendet dhe kahjet zhvillimore të ekonomisë në vendet e zhvilluara. Ekonomitë e vendeve të zhvilluara kryesisht janë mbështetur dhe kanë dhënë përkrahje zhvillimit të bizneseve prodhuese private, të vogla dhe të mesme që në mes veti janë

koncentruar dhe kanë bërë bashkëveprime në arritjen e plotësimit të kërkesave të tregjeve në vendet e tyre dhe në botë. Këto biznese prodhuese private, të vogla dhe të mesme duke iu falemnderuar infrastrukturave moderne të zonave dhe parqeve industriale si dhe përkrahjeve nga qeveritë e tyre, me kohë në bazë të veprimtarive të sukseshme janë zhvilluar në gjigante të përmendura me famë botërore dhe janë bërë shembuj për sukses në shumë vende të ndryshme të botës (komunale, 2007).

Edhe nëse është bërë përcjellja e trendeve dhe e kahjeve ekonomike në vendet e zhvilluara nga zyrtarët tanë të inkuadruar në qeverinë qendrore dhe ate lokale, kjo nuk është reflektuar në ekonominë e biznesit privat në Komunën tonë. Biznesi privat në Komunën tonë në sajë të mungesës së infrastrukturave moderne të parqeve industriale është lënë që ajo vetë të ballafaqohet me vështirësitë e kohës dhe vetë t'i bëjë zgjidhjet e duhura që shpesh kanë qenë të pamjaftueshme që të tërheqë investime të duhura të kapitalit vendor dhe të huaj. Biznesi privat deri më tani është lënë pa përkrahje, në mëshirë të kohës dhe konkurrencës së huajë.

Tani është koha e fundit që Komuna e jonë në këtë drejtim të japë kontributin e duhur dmth. të fillojë që seriozisht të meret me përkrahjen dhe punimin e Parkut Industrial për biznesin privat të instaluar në Komunën tonë (komunale, 2007).

.

2.3.1 Zona ekonomike?

Ekzistojnë një shtrirje e gjere e pajtimit se hapësirat dhe objektet e pershtatshme fizike, vendeve apo ndertesa me infrastrukture te qendrueshme, ne nje ambient te kontrolluar dhe menaxhuar mire, ne nje lokacion te pershtatshem, jane nje element shume i rendesishem ne cdo program per zhvillim te ndermarrjeve te nje vendi (Drejtoria per zhvillim ekonomik).

Ndermarrje te llojeve te ndryshme kerkojne hapësire me karakteristika te ndryshme dhe ne lokacione te ndryshme. Pra kocepti i hapësirave se punes, perkujdeset per lloje te ndryshme per ushtrimin e veprimtarive te ndermarrjave dhe perfshine ne vete: Inkubatorë te biznesit, zona industriale, parqe industrial – biznesi, park teknologjik, zone industriale, zone ekonomike e keshtu me radhe (Drejtoria per zhvillim ekonomik).

.

Sipas ligjit per zona ekonomike 03/L-129, perkufizimi “Zone ekonomike” nenkuptone nje zone gjeografike ne kuader te teritorit shteterore, qe ka nje status te vecante ekonomik e krijuar, per qellime te promovimit, apo zhvillimit te bizneseve.

Krijimi i zonave ekonomike ne republiken e Kosoves, rrjedhimisht ne komunen e Gjilanit kane per qellim:

- Nxitjen dhe inkurajimin e investimeve ne Gjilan, duke iu ofruar investitoreve infrastrukture te pershatshme per zhvillim te veprimtarive biznese;
- Te ndihmoje ne zhvillimin e pergjithshem ekonomik ne Gjilan, vecanerisht ne sektorin privat;
- Hapjen e vendeve te reja te punes dhe gjenerimin e te ardhurave;
- Terheqjen e teknologjive te zhvilluara;
- Perqendrimin e bizneseve ne nje vend te caktuar;
- Zgjerimin e bashkepunimit ndermjet bizneseve;
- Krijimin e kushteve per biznese ne menyre qe te kene qasjen me te lehte, ne lidhje me transportin publik, furnizimin me energji, uje, dhe sherbime te tjera, sa i perket mbeshtjes se biznesit (Drejtoria per zhvillim ekonomik).

2.3.2 Zona ekonomike ne Gjilan

Komuna e Gjilanit, ka filluar procesin e hulumtimit te mundesive per te krijuar disa zona ekonomike, rrjedhimisht pas themelimit te drejtorise per zhvillim ekonomik, aktualisht po punohet per licencimin e zones ekonomike rajonale ne fshatin llabjan te novoberdes, nje zone me mbi 70 ha siperfaqe, e cila do te jete zone ekonomike per rajonin e Gjilanit. Po punohet intensivisht, nga drejtoria e zhvillimit ekonomik (DZHE), edhe per gjetjen e hapësirave te pershtatshme per krijimin edhe te dy zonave tjera ekonomike lokale ne komunen tone (Drejtoria per zhvillim ekonomik).

Zonat ekonomike te themeluara dhe ato ne zhvillimi per nje kohe caktuar, te sigurojne nje asistence administrative, sherbime perkatese teknike e keshtu me radhe. Ato gjithashtu ofrojne sherbime te perbashketa ne ndermarresi, qasje ne paisje teknike, qira te pershtatshme dhe hapësira te shfrytezueshme, te gjitha ne nje kulm.

2.3.3 Zonat ekonomike me te suksesshme ne rajon?

Nje nder shtetet me te suksesshme ne rajon per funksionalizimin e zonave ekonomike eshte Maqedonia. Maqedonia eshte treguar tejet e suksesshme respektivisht ne zonat perreth, Shkupit, Tetoves dhe Shtipit. Qeveria Maqedonase perpos dhenies se tokave ne shfrytzim me çmim shume atraktiv, ka ofruar edhe lirime nga taksat per 3 – 10 vitet e para te operimit te biznesit, e kjo varesishte nga lloji i biznesit prodhues, si dhe lirime nga tatimi ne fitim per 50% ne 5 vitet e para per nepunesit maqedonas te cilet punesohen nga firma (Gap, 2012).

Per me shume vete qeveria eshte angazhuar ne ofrimin e ndihmave dhe trajnimeve per zhvillimin e ketyre bizneseve pa pagese me qellim qe t'i nxite investitorët drejte Maqedonise, ne raport me shtetet tjera ne Ballkan. Madje varesisht nga lloji i veprimtarise se biznesit prodhues, shteti Maqedonas po e promovon vendin edhe me fuqine e lire punetore, qe si rrjedhim ka sektorin e bujqesise dhe industrise (Gap, 2012).

2.4 Inkubatori i biznesit?

Qellimi kryesor i inkubatorit eshte qe te mbeshtese bizneset e reja, te cilat tregojne potencial per te qendruar mire financiarisht, pasi qe te dalin nga inkubatori pas nje periudhe tre vjeçare, keto biznese te mund te ushtrojne lirshem veprimtarine e tyre, veçanerisht te pavaresohen.

Inkubatori i biznesit (IB), eshte nje objekt i cili ofrone hapësire me çmim te ulet ne drejtim te mbeshtetjes se bizneseve, dhe zhvillimit te sherbimeve per bizneset e reja te themeluara dhe ato ne zhvillimi per nje kohe te caktuar.

Te sigurojne nje asistencë administrative, sherbime perkrahese teknike, ato gjithashtu ofrojne sherbime te perbashketa ne ndermarresi, qasje ne paisje teknike, qira te pershtatshme dhe hapësire te shfrytezueshme te gjitha ne nje kulm (Drejtoria per zhvillim ekonomik).

Sherbimet qe ofrohen nga inkubatori jane:

- Hapesire e gatshme dhe komode per akomodim;
- Periudha fleksibile te qirase;
- Qira e shkallezuar;
- Qasje e lehte dhe hapesire per parkim;
- Siguri e plote, qasje ne rryme, uje telefon dhe internet.

Lokacioni i objektit i cili eshte i destinuar per inkubatore te biznesit ne komunen e Gjilanit, gjendet Brenda qytetit. Ky inkubatore eshte i percjellur me nje infrastructure te kompletuar, si:

Ujesjelles, kyqje ne rrjetin elektrik, sherbime postare (PTT), kanalizim, parking te pershtatshem, qasje te lehte ne infrastrukturen rrugore, e keshtu me radhe. Hapesira qe eshte e destinuar per inkubatore, mbulon nje siperfaqe prej 1000m², Inkubatori i biznesit ka nje potencial prej 16 hapesirave punuese, njera nder to eshte:

- Zyra e menaxherit;
- Salla e trajnimeve qe jane te vendosura 12 biznese (Drejtoria per zhvillim ekonomik).

2.5 Parqet industriale?

2.5.1 Pershkrimi teknik i zones industriale per bizneset e vogla dhe te mesme

Punimi i projektit ideore i zones industriale vjene ne kohen e fillimit te privatizimit ne Kosove, Ne kohen e papunesise se larte dhe ne kohen kur deshirohet me te madhe te behet atraktive Kosova per investitoret e huaj dhe te vendit, qe ka per qellim uljen e shkalles se papunesise, respektivisht hapjen e vendeve te reja te punes dhe nje zhvillim te hovshem ekonomik ne regjion dhe ne Kosove (menaxhment, 2007).

Zona industriale, do te mundesoje nje impuls te ri per zhvillimin e bizneseve te vogla dhe te mesme. Do t'ju ofroje mundesi bizneseve siperfaqe te urbanizuara me infrastrukture moderne per zhvillimin e aktiviteteve ne rend te pare te atyre prodhuese. (menaxhment, 2007)

Bizneset potenciale qe jane duke kerkuar mundesite e nje biznesi te zhvilluar modern ne boten e globalizuar e cila eshte ne rritje e siper, per te hapur dyert e vizioneve te reja drejte prosperitetit dhe ardhmerise me zhvillimin e teknologjise, bashkepunimeve dhe lidhjeve nderkombetare, perpunimit dhe prodhimit te mallrave, realizimit te exportit – importit, dhenies se sherbimeve te tjera dhe realizimit te fitimit do te munde t'i arrijne te gjitha me lehte ne zonen industriale. (menaxhment, 2007)

2.5.2 Specifikacioni i hapësirave

Zona industriale perbehet prej siperfaqes e cila eshte prone e Kuvendit Komunal te Gjilanit, dhe qe per momentin nuk ka ndonje destinim te caktuar. E njejta siperfaqe ka baze te shendoshe per ndertim dhe nuk eshte toke pjellore (menaxhment, 2007).

Zona industriale shtrihet ne siperfaqen prej $S=142.640 \text{ m}^2$ (14.264 ha). Per nevojat e infrastruktures se rrugeve parashikohet gjeresia mesatare $b=10\text{m}$, me gjatesine e pergjitheshme te rrugeve, $L=3200\text{m}$ dhe ne pervojat e zhvillimit te bizneseve parashikohen te jene afer $n=100$, ngastra me siperfaqe te ngastres orientimisht $S=1000 \text{ m}^2$ (10 ar). Perfundimisht specifikacioni i siperfaqeve do te jete:

- Siperfaqe e pergjitheshme e ngastrave per biznese me Sbruto = 110640 m^2 (11.0640 ha).
- Siperfaqe e pergjitheshme e rrugeve me Sbruto = 32000 m^2 (3.2 ha).

Siperfaqja totale bruto e zones industriale eshte : Sbruto = 142.640 m^2 (14.264 ha) (menaxhment, 2007).

2.5.3 Lokacioni

Zona industriale do te shtrihet ne nje pozite te volitshme gjeostrategjike, sepse do te kete lidhje te afert me rrugen magjistrale, Gjilan – Prishtine dhe rrugen qarkore e cila mundeson kyçjen tranzitore me Bujanocin, Ferizajin dhe Prishtinen, e permes ketyre edhe me pjese tjera te Kosoves dhe jashte saj (menaxhment, 2007).

Zona industriale gjendet ne vendin e quajter “Gllama” e Livoqit te eperm, afer aeroportit bujqesore.

2.5.4 Infrastruktura

Ne kuader te zones industriale parashikohet te punohet me kete permbajtje si ne vijim :

- Sistemi i rrugeve dhe i trotuareve me siperfaqe te gjelbruara.

- Sistemi i ujit te pishem.
- Sistemi i ujerave fekale (Kanalizimi fekale).
- Sistemi i pastrimit te ujerave fekale.
- Sistemi i drenimit per ujerat atmosferike.
- Sistemi per shperndarjen e energjise elektrike dhe i ndriqimit te rrugeve.
- Sistemi i hidranteve dhe i aparateve per fikjen e zjarrit.
- Sistemi i lidhjeve telefonike.
- Si dhe sistemet e tjera te cilat do ti definoje ne te ardhmen koha (menaxhment, 2007).

Punimi i infrastruktures parashikohet qe te realizohet prej mjeteve financiare te grumbulluara nga komuniteti i biznesit ne zone ne emer te shfrytezimit te ngastrave per afat te caktuar kohore, supozojme 99 vite (menaxhment, 2007).

▪ **Perfituesit e projektit**

Perfituesit e projektit do te jene:

- Komuniteti i biznesit ne zonen industriale.
- Te papunesuarit te cilet do te inkuadrohen ne pune.
- Buxheti komunal dhe ai i Kosoves etj.

▪ **Perspektiva e projektit**

Realizimi i zones industriale do te jete nje model i mire per pune te ngjashme anembane Kosoves dhe jashte saj. Perspektiva e projektit te zones industriale do te jete ne koncentrimin e bizneseve, ne bashkepunim ne mes veti dhe integrimet e mundshme ekonomike me interes te perbashket (menaxhment, 2007).

KAPITULLI III

3.1 Industria në komunën e Gjilanit dhe themelimi i tyre ne shekullin e kaluar?

Në Komunën e Gjilanit, industria ka qenë një ndër faktorët më të rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e komunës. Industria ka qenë e përfaqësuar nga shumë degë të prodhimit, si në vijim: Industria e përpunimit të çelikut, ndustria përpunuese e tekstilit, industria përpunuese e duhanit, prodhimi i radiatorve të çeliktë, prodhimi i baterive industriale, ndërtimtaria e kështu me radhë. Shumica e këtyre ndërmarrjeve industriale punojnë me kapacitet shumë të vogël, ose e kanë ndërprerë aktivitetin e tyre prodhues, përshkak të rethanave të krijuara pas luftës në Kosovë (komunale, 2007).

Deri në vitet 90-ta, Gjilani kishte një ekonomi relativisht stabile, dhe ajo përbëhej nga: Kombinati i tekstilit, Kombinati i duhanit, Industria e baterive IBG, Fabrika e radiatorve dhe këmbyesëve të nxehtësisë, Industria e çelikut, shtypshkronja Grafikos, Elektrokosova, Morava e binçës, Kosovatransi, PTK, Agrokultura, Veterinaria, Stacioni i bujqësisë, Mirusha, Ekonomia e pyjeve, 28 Nëntori, Anamorava, Qarkullimi, Teuta, Kristali, Drita, Hidroteknika, Ndërmarrja komunale publike, Kualiteti, Hekurishtja e të tjera (komunale, 2007).

Mirëpo shfrytëzimi dhe administrimi jo i drejtë i këtyre kapaciteteve, gjatë dhjetë viteve të kaluara, periudhë kjo kur shqiptarët kanë qenë të privuar nga e drejta e punës, ka rezultuar që riaktivizimi i tyre të jetë i vështirë. Megjithatë pas luftës, në shumicën e tyre ka rifilluar prodhimtaria, me një kapacitet të vogël sa i përket numrit të të punësuarëve. Të gjitha këto industri gjigande të lartë cekur kanë qenë bartëse të zhvillimit ekonomik lokalë, por që reflektonte edhe në nivel qendrorë (Kosovë). Besohet se ardhmëria e tyre qëndron në procesin e privatizimit, i cili është duke shkuar me një tempo shumë të ngadalshëm (komunale, 2007).

3.2 Procesi i privatizimit të ndërmarrjeve publike?

3.2.1 Efektet e Privatizimit ne zhvillimin ekonomik te komunes se Gjilanit?

Privatizimi eshte nje nga qeshtjet kryesore dhe me te ndieshme sa i perket zhvillimit ekonomik te shteteve qe jane ne tranzicion. Ndryshimi i struktures pronesore dhe menyres se te menduarit nga prodhimi i planifikuar, ne ate te tregut, eshte ne te vertete nje ndryshim i domosdoshem. Privatizimi ne themel paraqet nje operacion afarist ne te cilen secila pale perpiqet te kaloje sa me mire, qe eshte e mundur. Mirepo parimi i drejtesise do te jete gjithmone problematike (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Ekonomia e republikes se Kosoves si dhe e vendeve te tjera ne rajon nuk jane ekonomi te cilat ndryshimet e tranzicionit ndodhin pavaresishte nga ndryshimet ne Bote, perkundrazi jane te varura nga ekonomia globale.

Ne praktike shpesh ndodhe qe ndermarrjet e privatizuara te jene ne qender te goditjeve pershkak te kushteve te imponuara te tranzicionit. Shkaku kryesor qe tranzicioni cilesohet si nje proces i veshtire eshte se nevojitet nje kohe e caktuar qe te rrenohet, sistemi i vjeter dhe te ndertohet sistemi i ri, perkatesishte ndermarrjet e reja te fillojne te operojne ne harmoni me kushtet e ekonomise se tregut. Roli i shtetit te Kosoves eshte qe te siguroje, nje program te mire, qe tronditja, qe eshte duke rrjedhur, e ketij lloj privatizimi, dhe ne adaptimin e kushteve te reja te jete sa me i lehte, duke identifikuar nje program te mire te zhvillimit qe do te mundesonte gjenerimin e vendeve te reja te punes, si dhe kanalizimin e aktiviteteve ekonomike ne sektor qe premtojne qendrueshmeri ekonomike, e njeherit kjo paraqet nje koncept te komplikuar per zbatimin e suksesshem te procesit te privatizimit (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Terheqja e investimeve te huaja direkte (IHD), eshte detyre thelbësore e privatizimit e seciles ekonomi ne tranzicion. Gjate viteve te fundit ne Kosove jane shenuar rezultate te rendesishme drejte krijimit te ekonomise se tregut dhe institucioneve te qendrueshme. Transformimi i prones shoqerore ne ate private, eshte cilesuar si nje hap kyq per ta bere Kosoven me nje ekonomi te pavarur dhe dinamike (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Korniza ligjore e privatizimit

Rregullorja 2002/12 e ndryshuar ne Rregulloren 2005/18, ka mundesuar themelimin e Agjencise Kosovare te mirebesimit, e njohur si (AKM). AKM-ja si organ i pavarura me identitet juridik te pavarur kishte kompetenca qe t'i administroje ndermarrjet ne pronesi shoqerore, (NSH) dhe ndermarrjet publike (NP) te regjistruara qe veprojne ne teritorin e Kosoves si dhe pasurine e ketyre ndermarrjeve. Ne Fillim AKM-ja kishte nje kapital prej 10 milion eurosh (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Qellimi kryesor i kesaj agjencie ishte privatizimi i plote i ndermarrjeve shoqerore, nga ku mandati fillestar i AKM-se ishte trevjeqar, kurse me hyrjen ne fuqi te rregullores 2002/12 dhe mandej me rregulloren 2005/18 mandati eshte caktuar si i pakufizuar (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Ndryshimi i rregullores eshte bere se rregullorja 2002/12 ka pasur lidhje me ndermarrjet e transformuara me ligjet e ish Jugosllavise apo me ligjet diskriminuese te Serbise, ku me rregulloren e re AKM-ja, ka pasur te drejte qe ti privatizojte te gjitha ndermarrjet shoqerore, pa marre parasysh ato a ishin te transformuara apo jo respektivisht t'i privatizojte te gjitha ndermarrjet e regjistruara deri me 31 dhjetore te vitit 1988 (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Transformimi i ndermarrjeve shoqerore ne shoqeri aksionare, sipas ligjeve te Serbise ishte nje argument i perdorur nga shtylla e IV e AKM-se, per nderprerjen e privatizimit te ketyre ndermarrjeve te transformuara ne baze te ligjeve te Serbise.

Organizimi i procesit te privatizimit

Agjencia Kosovare e Mirebesimit ishte e ngarkuar per ruajtjen dhe rritjen e vleres se ndermarrjeve ne pronesi shoqerore ne Kosove, si dhe ka qene pergjegjese per shitjen e aseteve ne pronesi te ndermarrjeve shoqerore. Numri totale i ndermarrjeve ne pronesi shoqerore, qe jane administruar nga AKM-ja, ishte diku reth 440 ndermarrje shoqerore. Deri me 31 Mars 2008 jane tenderuar 313 ndermarrje shoqerore, prej te cilave jane krijuar 549 ndermarrje te reja (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Themelimi i agjencise se re te privatizimit

Me institucionalizimin e jetes ne Kosove me modelet e demokracise perendimore gjithmone nen monitorim dhe kontrole nga bashkesia nderkombetare ku perfshihen edhe kompetencat e rezervuara, me 15 Qershor te vitit 2008, me hyrjen ne fuqi te kushtetutes se Kosoves, Kuvendi i Kosoves, aprovon ligjin, nr.03/L-067, me te cilin e themelon Agjencine Kosovare te Privatizimit, si nje organ i pavarur, publik i cili ushtrone funksionet dhe pergjegjesite, plotesishte ne menyre te pavarur, dhe ishte trashegimtare i AKM-se, e cila do te mirret me privatizimin e ndermarrjeve shoqerore. Nje ndryshim ne Agjencine e re eshte se ndermarrjet publike kalojne ne menagjim te Qeverise se Kosoves, te cilet me vone do te shendrohen ne shoqeri aksionare (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Industria e Tekstilit, Industria e Duhanit, Industria e Baterive, Fabrika e Radiatoreve, e industri te tjera qe kane qene gjigante, qe dikur kishte komuna e Gjilanit, tash te thuash jane boshe, pa prodhim e me puntore qe sorollaten rrugeve, ndersa privatizimi i tyre eshte percjelle me probleme te shumta, te cilave nuk po u shihet fundi.

Privatizimi i ndermarrjeve jo qe nuk rezultoi efekte, por demtoi ne mase te madhe industrine e komunes se Gjilanit.

Bujqesia, prodhimi i duhani, mishit, miellit, industria e tekstilit e metaleve, e çelikut, ajo e baterive, prodhimi i vidave e ndertimtaria, qe dikur komunen e Gjilanit e benin nje komune te njohure jo vetem ne Kosove, por edhe ne aspekt nderkombetare, tash thuajse, jane boshe, mandej tash e tutje vetem ne komunen tone, kerkojne pune mbi 21 mije kuadro te profileve te ndryshme. Ne te gjitha keto gjigande ekonomike, kur dikur prodhohej e punesoheshin shume te rinje te sapo diplomuar, tash e tutje jane shendrruar ne qendra tregtare e depo te mallrave te dryshme, duke rezultuar, qe procesi i privatizimit te stagnoje ne çdo aspekt (Sylqa, Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove).

Perfaqesues te bizneseve te ndryshme nga Gjilani, Dardana dhe Vitia, flasin per praktikat e gabuara te privatizimit.

Më poshtë në formë tabelare do të japim ndërmarrjet e privatizuara të komunës së Gjilanit

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Statusi	Gjendja e ndërmarrjes
1.	Industria e teksilit “Integj”	E privatizuar tërësisht	Punon vetëm, Fabrika e tepihëve klasik dhe pjesërisht tjertorja e re
2.	Industria e Duhanit	E Privatizuar me spinof special	Nuk punon, pritet vendimi i AKP-së, për ritenderim për mos përmbushjen e kushteve nga privatizimi.
3.	Fabrika e konstrukcioneve të Çelikut	E privatizuar	Punon vetëm reparti për prodhimin e roleneve
4.	Fabrika e baterive industriale IBG	E privatizuar	Nuk punon
5.	Fabrika e radiatorve	E privatizuar	Punon
6.	Agrokultura	E privatizuar pjesërisht (disa njësi)	Punojnë njësit e privatizuara
7	Industria ndërtimore “Morava e Binçës”	E privatizuar	Punon vetëm Gurëthyesi
8.	Ndërmarrja tregtare “28 Nëntori”	E privatizuar	Punon

9.	Ndërmarrja tregtare “Agromorave”	E privatizuar	Punon
10.	Industria e miellit dhe Bukës “Kualiteti”	E privatizuar	Ka punuar por tani nuk punon, është shitur për ndërtime të larta
11.	Ndërmarrja transportuese “Kosovatrans”	E privatizuar	Nuk punon
12.	Stacioni i Autobusëve	Nuk është privatizuar	Punon
13.	Barnatorja e populllore	E privatizuar	Punon
14.	Koperativa rrobaqepëse “Teuta”	E privatizuar	Nuk punon
15.	Ndërmarrja tregtare “Mirusha”	E privatizuar	Nuk punon

Burimi: Kuvendi komunal, Drejtoria për ekonomi dhe menaxhment.

Të gjitha këto ndërmarrje të lartpërmendura, janë privatizuar me spinoff të thjeshtë përveç Industrisë së Duhanit, e cila është e privatizuar me spinoff special, por përshkak të mos përmbushjes së obligimeve ligjore është në fazën e ritenderimit, rrjedhimisht ndërmarrjet e privatizuara punojnë me një kapacitet prej 20%, si pasojë e mungesës së investimeve dhe menaxhimit të dobët (komunale, 2007).

Vlera e privatizimit të ndërmarrjeve publike, numri i të punësuarëve dhe viti kur janë privatizuar?

Ne tabelën e mëposhtme, i kam marrë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërmarrjet, e privatizuara, për nga vlera e privatizimit, numri i të punësuarëve dhe viti në të cilën janë privatizuar, sa i përket komunes sone.

Nr.	Emri i ndërmarrjes	Vlera e treg.	Numri i punëtor.	Sipërfaqja e aset. m2	Viti i shitj.
1	Industria e tekstilit "INTEGJ"	1100000	812	15585 m2	2006
2	Industria e Duhanit "TOBACCO"	1400000	90	49557 m2	2006
3	Fabrika e konstrukcioneve të Çelikut	625376	171	53148 m2	2005
4	Fabrika e baterive industriale "IBG"	3255513	318	75231 m2	2012
5	Fabrika e radiatorëve "JUGOTERM"	1112100	282	52581 m2	2012
6	Agrokultura	211000	256	2160261 m2	2006
7	Industria ndërtim. "MORAVA E BINÇËS"	1222222	544	20678 m2	2008
8	Ndërmarrja tregtare "28 NENTORI"	652000	255	9015 m2	2006

9	Ndermarrja tregtare "AGROMORAVA"	26500	123	10546`m2	2014
10	Industria e miellit dhe Bukes "KUALITETI"	1810000	370	18318 m2	2008
11	Ndermarrja transport. "KOSOVATRANS"	865000	158	29890 m2	2006
12	Shtypshkronja "GRAFIKOS"	452777	56	3510 m2	2009
13	Barnatorja Popullore	712000	18	400 m2	2006
14	Koperativa rrobaqepse "TEUTA"	70250	50	276 m2	2005
15	Ndermarrja tregtare "MIRUSHA"	109500	11	7311 m2	2009
	Vlera e pergjithshme e aseteteve	13624238			

Burimi: Agjencia Kosovare e Privatzimit

3.3 NVM-të dhe krijimi i tyre në komunën e Gjilanit?

Me suprimimin e autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe me suspendimin e punëtorëve shqiptarë nga vendet e tyre të punës, gjendja e popullsisë ekonomike u përkeqësua në mënyrë të jashtëzakonshme. Në bazë të vlerësimit të institutit ekonomik në Prishtinë, në fillim të viteve të 90-ta, reth 100.000 deri 150.000 punëtorë shqiptarë, ose 80 % e popullsisë në moshë pune, ishin pushuar nga puna, nga ana e regjimit serb (Shiroka - Pula, 2013,).

Nga ky terorrë famëkeq serb nuk shpëtojnë as komuna e Gjilanit, duke lënë qindra punëtorë në rrugë, respektivisht të përjashtuar nga puna, nga sektori shoqërorë. Disa prej tyre emigruan në vendet e perëndimit, duke kërkuar punë dhe një jetë më të mirë. Pastaj një pjesë e popullsisë konsistonin, në themelimin e ndërmarrjeve private, në mënyrë që mos t'ju vështësohet gjendja e tyre ekonomike, rrjedhimisht pas vitit 1990, rezultoi zhvillimi i sektorit privat (Shiroka - Pula, 2013,).

Kosova gjatë viteve të 90-ta, por edhe Gjilani është ballafaquar me kriza të thella sociale, politike dhe ekonomike. Edhe pse pas vitit 1999 gjendja në Kosovë rrjedhimisht edhe në Gjilan filloi të ndryshojë për të mirë, bizneset Kosovare akoma ballafaqohen me barriera apo pengesa në sigurimin e mjeteve financiare, zgjerimin e prodhimit, etikën në biznes,

marrëdhëniet në eksport – import dhe në ekspertizë. Ekonomia e komunës së Gjilanit edhe më tej ngelet në një nivel të ulët zhvillimi (Shiroka - Pula, 2013.).

Ekonomia e Gjilanit prej periudhës 1990 – 1994, realizoi një normë negative të produktit shoqëror, por edhe në të gjithë treguesit makroekonomikë. Ekonomia e komunës së Gjilanit pas veteve të 90-ta u karakterizua me parametra negativë. Një rënie e tillë kulmon me kolapsin e plotë të ekonomisë private në Gjilan gjatë periudhës 1996 – 1998, (periudha e luftës), ku shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) bankrotojnë apo shuhet, mandej themelimi i ndërmarrjeve të reja bie gati në zero (Shiroka - Pula, 2013.).

Nga periudha e pas luftës 1999, ekonomia private respektivisht biznesi i vogël dhe i mesëm në Kosovë, por edhe në komunën tonë, konsiston me zhvillim ekspansiv dhe atë si në aspektin kuantitativ poashtu edhe në aspektin kualitativ. Ekonomia e komunës së Gjilanit përbëhet nga një ekonomi e re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar me një ekonomi centraliste e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të tregut. Me këtë ekonomi kërkohet rritja e konkurrencës së saj, duke rritur kapacitetin eksportues, për të zvogëluar deficitin tregtar që mbretëron ende në komunë (Shiroka - Pula, 2013.).

Gjilani është një vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit dhe ofron disa përparësi komparative si në vijim: popullsia e re dhe e kualifikuar, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politikat fiskale dhe taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe në atë të Bashkimit Evropian (Shiroka - Pula, 2013.).

Shteti ynë, rrjedhimisht Kosova në qershor të vitit 2009 është anëtare e CEFTA-s, e Fondit monetar Ndërkombëtar (FMN-së), Bankës Botërore (BB-së) dhe Bankës Evropiane për zhvillim dhe rindërtim (BERZH), nga ku aspirojnë në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomik – financiarë, si Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) e kështu me radhë (Shiroka - Pula, 2013.).

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) përpos kursimeve vetjake, financimi i tyre sigurohet dhe realizohet nga institucionet mikrofinanciare dhe nga linjat kreditore të bankave komerciale, që operojnë në vendin tonë, por që vazhdimisht janë të larta, sa i përket shkallës së interesit, megjithëse kanë tendencë të përmirësimit, por me një tempo relativisht të vogël (Shiroka - Pula, 2013.).

Aplikimi për kredi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), nga ana e bankave komerciale, ka tendencë të përmirësimit në krahasim me vendet e tjera në rajon, mirëpo kjo situatë apo mundësi rrit koston e një kredie biznesore në vendin tonë (Shiroka - Pula, 2013.).

Krijimi i ndërmarrjeve, në shumicën e rasteve, është bërë pa koncept të përpunuar, rrjedhimisht, nuk ekzistonte specializimi për veprimtari të caktuar, punohej prej rastit në rast. Në strukturën e ekonomisë private, gjithnjë kanë dominuar ndërmarrjet tregtare. Shumica e tyre, periudhë pas periudhe falimentonin, apo e ndërronin veprimtarinë në të cilën operonin (Shiroka - Pula, 2013.).

Zhvillimi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), duhet të jetë katalizatori themelor i rritjes ekonomike dhe hapjes së vendeve të reja të punës. Ky zhvillim duhet të ketë mbështetje, në përparësitë të cilat duhet të zhvillohen më tutje dhe në pengesat dhe dobësitë, me strategji dhe masa të politikës ekonomike, duhet të tejkalohen dhe të relativizohen (Shiroka - Pula, 2013.).

Njëra nga modelet e shumta të parashikimit apo vlerësimit të gjendjes së ndërmarrjeve është analiza SWOT, rrjedhimisht një metodë e cila mund të krijojë një sistem, që prezenton praktikë të marrjes së informatave, nga brenda dhe jashtë, sa i përket aktivitetit biznesor, duke i paraqitur prioritetet afatshkurtër dhe afatgjatë dhe duke lejuar një mënyrë të lehtë të ndërtimit të grupit të menaxhmentit, i cili ka për synim arritjen e objektivave, lidhur me rritjen e fitimit (Shiroka - Pula, 2013.).

SWOT analiza, (Strength) Fuqitë, (Weakness) Dobësitë, (Opportunity) Mundësitë dhe (Threats) Kërcënimet, është një metodë shumë e dobishme, për të përcaktuar faktorët e brendshëm dhe të jashtëm, të cilët ndikojnë në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve). Teknika e lartpërmendur, si e tillë paraqet njërin prej teknikave bazë, të cilët shërbejnë për ndërmarrjen e një analize më strukturore të mjedisit të biznesit, që ka për qëllim formulimin e një strategjie për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-ve), e cila do të ishte lehtë e implementueshme apo do të implementohet në mënyrë të lehtë (Shiroka - Pula, 2013.).

Në kuptimin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), në Kosovë rrjedhimisht edhe në Gjiilan, deri tani janë identifikuar 18 fuqi të ndryshme. Shumica dërmuese e këtyre fuqive kanë të bëjnë me rritjen e vazhdueshme të Bruto Prodhimit Vendor (BPV), koston së ulët të fuqisë punëtore të shkolluar dhe në moshë të re, aprovimin e Aktit

për Biznese të Vogla (ABV), si dhe rritjen e shkallës së harmonizimit të politikave Kosovare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) e Bashkimit Evropian (BE) (Shiroka - Pula, 2013,).

Strategjia për zhvillimin e NVM-ve, ka krijuar një arsenal masash dhe instrumente për inspirimin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve), që posedojnë rritje të shpejtë dhe koncept ofensiv të zhvillimit. Poashtu aktiviteti dhe masat specifike mund të merren në sektorë të caktuar: Agrobiznesi, shërbime informatike, programe prodhuese, veprimtari biznesore të fermave, shërbimet e konsaltingut dhe edukimin e bizneseve (Shiroka - Pula, 2013,).

3.4 Infrastruktura fizike për biznes?

Në përgjithësi infrastruktura është në nivel jo të kënaqshëm dhe nuk i plotëson nevojat sa i përket banorëve të komunës, duke filluar nga sasia jo e mjaftueshme e ujit, të pijshëm, rrjeti i vjetruar i kanalizimit, dhe rrjeti i vjetruar i post telekomit dhe telekomunikacionit (PTT-së), Pastaj është nevojë e domosdoshme, investimi në evitimin e problemeve të cilat shkaktojnë mosfunksionim të infrastrukturës së duhur për biznes.

Parakusht për zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik është edhe modernizimi i infrastrukturës energjetike dhe të trafikut që nënkupton modernizimin e trafikut rrugor, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, respektivisht rrjetit energjetik dhe racionalizimin e komunikacionit dhe lidhjeve.

Shërbimet komunale të cilat iu ofrohen qytetarëve në Komunën e Gjilanit janë:

- Furnizimi me ujë të pijshëm,
- Higjiena publike, bartja e mbeturinave nga shtëpia deri te deponitë,
- Furnizimi me rrymë elektrike,
- Shërbimi i zjarrëfiksëve,
- Ndriqimi i rrugëve dhe i parqeve,
- Ndërmarrja për distribuimin e rrymës elektrike “KEK me njësi në Gjilan”
- Ndërmarrja për furnizim me ujë të pijshëm ish “HIDROTEKNIKA” tani “HIDROMORAVA”,
- Ndërmarrja për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike “HIGJIENA”, e kështu me radhë.

Është një ndërmarrje transportuese shoqërore në komunë, rrjedhimisht 21 kompani private, transportuese, si dhe 136 autotaksi, mungonë transporti hekurudhorë, respektivisht stacioni më

i afërt i trenit është në komunën e Ferizajit, 33 km larg komunës së Gjilanit. Aeroporti më i afërt është në Prishtinë gjegjësishtë reth 60 km larg nga Gjilani (komunale, 2007).

3.5 Strategjia e zhvillimit të planit strategjik?

Me planet strategjike ne përpiqemi që t'i rregullojmë parimet bazë, politikat, përparësitë, dhe metodat për t'i promovuar ato, si dhe përcaktimin e afateve kohore, dinamikën e realizimit qofshin ato afatmesëm apo afatgjatë. Hartimi i një plani është me rëndësi për komunën e Gjilanit, me qëllim të përcaktimit të përparësive, përdorimin efektiv të burimeve dhe parimet bazë të menaxhimit, pjesëmarrjes, transparences dhe matëshmërinë, me anë të indikatorëve mates të përcaktuar që më parë (komunale, 2007).

Planifikimi strategjik është një proces pjesëmarrje dhe fleksibël, që mbanë parasysh situatën egzistuese, vizionin, misionin dhe parimet bazë për:

- Formimin e një vizioni
- Përcaktimin e objektivave dhe synimeve të përshtatshme për këtë vizion dhe
- Vlerësimin, monitorimin, nëpërmjet përmirësimit të indikatorëve të matshëm të përcaktuar që më parë (komunale, 2007).

Me rstin e hartimi të planit strategjik të komunës së Gjilanit, ne përpiqemi, në bazë të informatave që i posedojmë, t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve:

- ✓ Përshkrimi i situatës së tanishme të komunës së Gjilanit, ne këtë e kemi bërë në fillim aq sa kemi pasur informata, duke analizuar mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm,
- ✓ Qëllimi që ne dëshirojmë të arrijmë me këtë strategji, respektivisht duke analizuar situatën sa më reale të komunës,
- ✓ Si mund t'i arrijmë qëllimet tona të përcaktuara nga kjo strategji, përshkrimi i rrugës në arritjen deri në destinacionin e duhur.

Në fund ngelet nga ana jonë që të bëjmë vlerësimin e suksesit tonë, dhe monitorimin e tij.

Me monitorim dhe vlerësim na ipet mundësia që të ndjekim suksesin tonë, ku dëshirojmë që të bëhemi në të ardhmen (komunale, 2007).

3.6 Strategjia për gratë ndërmarrëse në komunën e Gjilanit?

Qëndrimet patriarkale të burrave, por edhe të grave në Kosovë, rrjedhimisht edhe në komunën e Gjilanit, ende paraqesin një pengesë të konsiderueshme për zhvillimin e ndërmarrësisë së grave në nivel lokal. Krijimi i kushteve për zhvillimin e ndërmarrësisë,

respektivisht, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM), do të jetë njëri nga prioritet, kryesore në nivel komunal, por edhe në nivel qendrorë (Kosovë) (support, 2017).

Barriera më e madhe në zhvillimin e ndërmarrësisë së gruas, ka të bëjë me disa vlera, që do të jenë rezultat i trashëgimisë shekullore kulturore. Poashtu për gruan bëhet fjalë, që është shumë e vështirë t'i mbajë dy punë, njëren për të ushtruar profesionin e tij, dhe të dytën për të mbajtur familjen. Për gruan gjithnjë është konsideruar, se është e pa përshtatshme për disa profesione, mandej nuk është e përshtatshme për disa profesione tjera, supozojmë, se gruaja është shumë e përshtatshme që të merret me profesionet e shërbimeve dhe në edukimin arsimorë (support, 2017).

Për gruan është e vështirë që të kërkojë hua në formë të kredisë, në njëren nga bankat komerciale, megjithëse shumica e tyre, nuk posedojnë ndonjë pronësi në emër të vet, pastaj nuk mund të ketë qasje në resurse financiare. Kjo barrierë që bie mbi gratë ndërmarrëse, potencohet, kur ato fillojnë të themelojnë një biznes të ri. Njëra ndër faktorët e kësaj barriere është prezenca e ekonomisë jo formale, e cila e cenon tregun e punës, si në nivel lokal, poashtu edhe në atë qendrorë (support, 2017).

Një barrierë tjetër shtesë është mungesa e trajnimeve dhe programeve edukative të cilat do të inspironin gratë, që idetë dhe dëshirat e tyre t'i kthejnë në aktivitete konkrete të biznesit.

Megjithëse edhe nëse egziston mbështetja ndaj grave ndërmarrëse, ajo është e diferencuar në varësi të lokacionit, ngase më shumë mbështeten, gratë në vendbanimet urbane në raport me ato rurale. Strategjia e zhvillimit të ndërmarrësisë së grave, ka për qëllim krijimin e kushteve dhe ambientit të përshtatshëm, për hapjen e bizneseve të reja dhe rritjen e zhvillimit të atyre ekzistuese, që gjithsesi do të kontribuonte në zvoglimin e papunësisë në këtë komunë (support, 2017).

Rezultatet kryesore të cilat duhet të realizohen brenda kornizës së strategjisë janë:

- ✓ Ndryshimi i pjesëmarrjes në strukturën e pronësisë në ndërmarrësinë e grave,
- ✓ Mbështetja e grave për të themeluar biznese të reja start - up,
- ✓ Mbështetja e grave për të vazhduar bizneset ekzistuese,
- ✓ Mbështetja e grave në biznes për t'u lidhur në mes vete, qoftë nivel lokal, regional, gjithsesi edhe në nivel qendrorë (Kosovë) (support, 2017).

Nga arritja e këtyre rezultateve komuna e Gjilanit, do t'i qaset përmes disa veprimeve startegjike, të cilat do të jenë në korrelacion të drejtpërdrejtë:

- Krijimi i rrethanave të përshtatshme për mbështetjen e zhvillimit të ndërmarrësisë së grave,
- Krijimi i kushteve më të mira për financimin e aktiviteteve të grave,
- Krijimi dhe ofrimi i njohurive të nevojshme për menaxhimin e biznesit të grave, dhe
- Krijimi i mundësive të lidhjes së grave në biznes (support, 2017).

KAPITULLI IV

4.1 Sistemi i edukimit, shkollimit dhe aftësimit profesional të banorëve të komunës?

Është fushë me theks të veçantë për zhvillimin strategjik të komunës së Gjilanit, në periudhën kohore: afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Faktori njeri është faktori i pazëvendësueshëm, dhe gjithnjë i nevojshëm, për ushtrimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës. Njeriu si pjesëtar i popullatës mund të jetë faktor i pazëvendësueshëm dhe gjithnjë i nevojshëm vetëm nëse arrihet që nëpërmjet sistemit të edukimit, shkollimit dhe aftësimit profesional modern, e cila e përcjellë në hapë me kahjet dhe trendët e zhvillimit të komunave, në vendet e zhvilluara, të arrijë që të aftësohet deri në shkallë të duhur, për të kontribuar në realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës. Në këtë drejtim duhet pasuar parasysh, se si të bëhet ngritja e vetëdijes kolektive, të popullatës, në mënyrë që kjo të mos paraqitet si faktor që pengon në zhvillimin ekonomik të komunës (komunale, 2007).

Fusha e sistemit të edukimit, shkollimit dhe aftësimit profesional, duhet të jetë një gjeneratorë i formimit të kuadrove të nevojshme për zhvillimin ekonomik lokal, me një vetëdije të ngritur kolektive e cila mundëson bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e ideve dhe realizimeve të ndryshme. Sistemi i edukimit, shkollimit i instaluar në komunë, duhet të jetë në trendin e zhvillimit ekonomik dhe të jetë paraprijës i ndryshimeve pozitive në ekonomi dhe shoqëri. Sistemi i edukimit, shkollimit në formën e deritanishme ka krijuar kuadro të gjeneratave të reja, pa u bazuar në ndonjë nevojë, të një strategjie të zhvillimit ekonomik lokalë (ZHEL) (komunale, 2007).

Forma e sistemit të shkollimit, në shkollat e mesme, duhet të ketë më tepër mundësinë e aftësimit praktik, të nxënësve në raport me at teorik. Për realizim të këtillë të shkollimit të mesëm, duhet që Drejtorati për Arsim që funksiononë në kuadër të komunës, të bashkëpunojë dhe bashkëveprojë, me bizneset dhe ekonominë e instaluar në komunën e Gjilanit, në mënyrë që të mundësojë, shkollave të mesme, realizimin e aftësimit praktik nëpër këto biznese. Forma e këtillë do t'i ndihmojë shkollave, që të krijojnë kuadro të afta profesionale dhe bizneseve do ti mundësojë, që më lehtë të vijnë deri te këto kuadro të nevojshme për zhvillimin e kapaciteteve të tyre në kuadër të zhvillimit ekonomik të komunës (komunale, 2007).

Komuna në fushën e sistemit të edukimit, shkollimit dhe aftësimit profesional, duhet të investojë dhe të kontribuojë, më shumë në mënyrë të vazhdueshme, duke mundësuar realizimin e programeve moderne, të shkollimit, që mundësojnë realizimin e strategjisë së zhvillimit ekonomik të komunës (komunale, 2007).

4.3 Hapësirat apo tokat bujqësore?

Janë hapësirat ku do të shtrihen sipërfaqet e dedikuara për banim të qytetarëve si të atyre individualë poashtu edhe të banimit kolektivë, me infrastrukturën përcjellëse të ujësjellësit, kanalalizimit atmosferik e fekal, elektrifikimit, gazësjellësit, lidhjeve telefonike e informatike, rrugëve të asfaltuara etj. Me sipërfaqen dhe objektet tjera përcjellëse që e përbëjnë tërësinë e hapësirave të banimit (parqet, parkingjet, hapësirat për lojë dhe freskim, ambulancat, shkollat, objektet tregtare, objektet kulturore dhe të sportit, objektet për shërbime postare, objektet hotelierike, objektet bankare, restaurantet, strehimoret dhe objektet tjera me sipërfaqet e veta të mjaftueshme të gjelbërimit, parkimit, e kështu me radhë (komunale, 2007).

Në kuadër të kësaj hapësire të përmendur duhet pasur gjithashtu parasysh shtrirjen e hapësirave ndërtimore jashtë sipërfaqeve të tokave bujqësore, ngase komuna e Gjilanit posedon një sipërfaqe të vogël të tokës pjellore. Nëse me planin gjeneral urbanistik nuk parashihet që të njejtat sipërfaqe të sigurohen për mbjelljen dhe kultivimin e prodhimeve bujqësore, mandej kjo do të jetë një strategji e gabuar me shumë pasoja. Në rend të parë si pasojë do të jetë zvoglimi i sasive të prodhimit bujqësore, prej nga rrjedh edhe zvoglimi i numrit të punëtorëve, që ka mundësi të merren me këto veprimtari bujqësore, në anën tjetër do të kemi edhe rritjen e shkallës së papunësisë, që është një ndër problemet kyçe në komunën tonë (komunale, 2007).

Po ashtu në kuadër të kësaj hapësire duhet të kemi parasysh edhe aftësinë e dobët, mbajtëse të tokave pjellore, që në aspektin e ndërtimit aseizmik, paraqet një rrezik të lartë, duke pasur parasysh që komuna e Gjilanit, edhe ndodhet në zonën e IX –të seizmike.

Komuna me një plan gjeneralë urbanistik, duhet që të identifikojë, këto hapësira të banimit, dhe të mundësojë ndërtime me plane detale urbanistike, në një mënyrë më bashkëkohore, duke krijuar mundësi, të punëve të reja dhe vendeve të punës, për sektorin e ndërtimtarisë, e cila hapë rrugë edhe sektorëve të tjerë që të kenë mundësi të angazhimit, dhe të punës, në anën tjetër komuna do t'i mundësojë qytetarëve që të kenë shumë më lehtë zgjidhjen e problemit të banimit, me një infrastrukturë të përkryer dhe të planifikuar, si dhe do të

mundësojë në mënyrë indirekte edhe të hyra për buxhetin komunal të Gjilanit, rrjedhimish edhe për buxhetin në nivel qendrorë, Kosovë (komunale, 2007).

Duke marrë parasysh se siç është cekur më lartë, komuna jonë posedon tokë jo të mjaftueshme bujqësore, pastaj gjithësesi orinetimi në ndërtim të jetë në drejtim vertikal, për ta kursyer tokën po ashtu jo të mjaftueshme, por jo më tepër se P+5, ose P+6, përshkat të jo stabilitetit seizmik të komunës (komunale, 2007).

4.3.2 Hapësirat bujqësore

Janë sipërfaqet e destinuara për ushtrimin e veprimtarive bujqësore, në kuadër të kësaj hapësire kemi tokat pjellore, që mundësojnë kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, përmes serrave dhe fushave të hapura pjellore, përmes kullosave dhe fermave të ndryshme, mundëson rritjen e fondit të bagëtisë, dhe të prodhimeve përcjellëse, përmes pemishteve dhe plantazheve për prodhimin e fryteve të ndryshme ekologjike, me mundësi të përpunimit final, mundëson furnizimin e tregut vendor, me këto prodhime bujqësore si dhe të eksportimit edhe jashtë vendit (komunale, 2007).

Këto hapësira bujqësore kanë rëndësi të veçantë në kuadër të zhvillimit strategjik, të ekonomisë në komunë, dhe mundësojnë zhvillimin e fermerëve privatë të cilët edhe duhet të jenë, bartës të zhvillimit të bujqësisë, që reflekton pastaj edhe në zhvillimin ekonomik lokalë (ZHEL). Për këto hapësira bujqësore duhet që komuna të posedojë rregullore të posaqme, në ruajtjen dhe mbrojtjen e sipërfaqeve bujqësore, në mënyrë që ato të parashihen vetëm për destinim të veprimtarisë bujqësore, e jo që të njëjtat të shfrytëzohen edhe për nevoja të ndërtimit, të objekteve të banimit, apo të ndërtimit të fabrikave industriale (komunale, 2007).

Komuna duhet të mundësojë dhe të bëjë iniciimin e punimit të programeve dhe projekteve të ndryshme në kuadër të planit strategjik, të zhvillimit ekonomik të komunës për menaxhimin e këtyre sipërfaqeve bujqësore përmes fermerëve që shtrihen mbrenda komunës, me qëllim të shfrytëzimit të tyre në mënyrë sa më optimale (komunale, 2007).

Komuna me një angazhim adekuat në këtë drejtim, duhet që me rregulloret komunale të parashihet edhe bashkimin e arave në mënyrë që të mundësojë fermerëve profesionalë që të kenë sipërfaqe më të mëdha për punë dhe në anën tjetër, të eliminohen sipërfaqet e tokave të papunuara. Nëse komuna me ligjet dhe rregulloret komunale do të bëjë iniciimin e bashkimit të arave tani fermerëve profesionalë do t'u mundësohej të realizojnë punë në sipërfaqe më të mëdha, në këtë mënyrë do të ketë kuptim që fermerët profesional të bëjnë modernizimin e

punës, duke bërë investime të nevojshme në infrastrukturë, objekte përcjellëse dhe teknike të duhur. Si rrjedhim do të vije deri te rritja e vendeve të reja të punës dhe produktivitetit nga këto hapësira, do të jetë më e madhe dhe më rentabil. Me këto veprime në mënyrë indirekte do të realizohen edhe të hyra edhe për buxhetin komunal të Gjilanit, respektivisht edhe për buxhetin e konsoliduar të Kosovës (komunale, 2007).

4.4 Hapësirat e zonave industriale?

Janë hapësirat ku do të shtrihen sipërfaqet dedikuara për ndërtimin e zonave industriale me infrastrukturën më moderne, të nevojshme për funksionimin e tyre. Të njëjtat sipërfaqe duhet të parashihen, jashtë zonave të banimit, dhe sipas mundësive duhet të zgjidhen konfiguracionet kodrinore, jashtë sipërfaqeve pjellore, me mundësi që të kenë kyçje të mirë me infrastrukturën regjionale, dhe të autoudhëve, hekurudhave dhe të komunikacionit ajrorë. Planifikimi i zonave industriale, hapë rrugën investitorëve vendorë dhe të huaj, që të investojnë në komunën e Gjilanit, si rrjedhim i investimeve vjen deri te hapja e bizneseve të reja, bëhet koncentrimi dhe bashkëpunimi ndërmjet bizneseve lokale, bizneseve me investim të përzier dhe bizneseve me investim të huajë (komunale, 2007). Në këtë mënyrë zonat industriale me një infrastrukturë të zhvilluar dhe të projektuar në kuadër të planit general urbanistik, do të jenë një gjeneratorë i mirë i fillimit të realizimit, të një zhvillimi strategjik, të ekonomisë në komunë, ku do të mundësojnë që ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të), si dhe mikrondërmarrjeve, respektivisht zejtarëve të vegjël, të koncentrohen në hapësirat e zonave të organizuara industriale, me mundësi të bashkëpunimit, më real në mes veti dhe me mundësi më të lehtë të gjetjes, së partnerëve vendorë dhe të huaj, për investime të përbashkëta, me qëllim të rritjes së përqindjes së prodhimit të produkteve vendore, në krahasim me prezencën e produkteve të huaja në tregun e Kosovës dhe jashtë sajë (komunale, 2007).

Ndërtimi i zonave industriale ofron kushte për gjenerimin e vendeve të reja të punës, rrjedhimisht aftësimin e kuadrove të reja, me praktikën profesionale, rritjen e kapaciteteve prodhuese, çmimin e ulët të kostos së prodhimit, respektivisht mundëson bizneset të jenë më konkurrentë, në tregun vendorë dhe at të jashtëm, bënë zvoglimin e pa punësisë, si dhe në mënyrë indirekte, mundëson rritjen e buxhetit të komunës së Gjilanit, rrjedhimisht edhe buxhetit të Kosovës (komunale, 2007).

KAPITULLI V

5.1 Lehtesimet e infrastruktures elektronike lokale ne ofrimin e sherbimeve te ndryshme komunale, si dhe ne berjen e biznesit?

Shumica e sherbimeve publike dhe administrative online jane sherbime komplekse, pastaj, informatat e nevojshme per te ofruara sherbime publike dhe administrative ruhen ne disa organe dhe autoritete publike, te cilat ofrojne sherbime publike dhe administrative online (ekonomik, 2013).

Aktualisht, shume pak sherbime jane deponuar ne hapesiren kibernetike te Kosoves, rrjedhimisht edhe ne komunen e Gjilanit, me qe ato nuk perdoren shpesh. Nje numer i vogel i sherbimeve publike dhe administrative jane transferuar ne mediumin elektronik te Kosoves, krahasuar me shtetet e BE-se, (Deklarimi i pagesave pe tatimin ne paga, kontributeve pensionale, tatimin ne fitim, tatimin e paragjykuar e keshtu me radhe permes platformes online nga administrita tatimore e Kosoves, me njesite rajonale ne Gjilan dhe ne cdo qytet te Kosoves, poashtu edhe pagesa online permes e-banking e ofruar nga ana e bankave komerciale qe operojne ne kosove dhe ne komunen tone) (ekonomik, 2013).

Sipas raportit te 9-te krahasimor (http://ec.europa.eu/information_society/newsroom/cf/item-detail-dae.cfm?item_id=6537), qe ka te beje me disponueshmerine e plote te sherbimeve publike dhe administrative online, BE-ja ka arritur nje mesatare prej 82% ne vitin 2010, ne raport me 69% ne 2009-ten. Ne realitet, duhet te merret parasysh se internet eshte duke u bere mjeti me i rendesishem per ofrimin e sherbimeve te ndryshme ne formen online, duke ua bere sa me te lehte secilit perdorues qasjen ne informata globale apo Boterore (ekonomik, 2013).

Ne kuader te Ministrise se tregtise dhe industrise (MTI-se) vepron, Agjencia per regjistrimin e bizneseve ne Kosove e njohur si (ARBK), qe eshte institucion i vetem pergjegjes per regjistrimin e bizneseve ne Kosove. Agjencia per regjistrimin e biznesit (ARBK), funksionon ne baze te nje sistemi elektronik te dhenave, si nje proces me i thjeshte, me i shpejte, pa shpenzime per regjistrimin e bizneseve fillestare, qe realizohet permes lidhjes ndermjet 29 qendrave komunale te regjistrimit, me mundesi te shtimit te tyre te njohura si “one stop shop” me zyren qendrore te ARBK-se (<https://www.rks-gov.net>).


Sistemi aktual ka ndikuar ne rritjen e transparences, si dhe ka nje rritje te standardeve dhe perpjekjeve, per te harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Evropian.

ARBK është institucion i orientuar drejtë zhvillimit, që ofronë arritjen e efikasitetit me të madhe, me një cilësi të lartë për të gjithë operatorët ekonomik që operojnë në Kosovë, respektivisht edhe në komunën e tonë (<https://www.rks-gov.net>).

Fokusi ynë është krijimi i një imazhi ndihmes për thjeshtimin e procedurave administrative të regjistrimit në ndihmë të bizneseve dhe ofrimin e infrastruktures elektronike, për përmirësimin e ambientit biznesor në nivel lokal. Qëllimi ynë është të ofrojmë shërbime institucionale të përgjegjshme dhe të krijojmë një kulturë administrative tek bizneset. Staf i profesional i kësaj agjencie, ka arritur nivelet me të larta të cilësisë në shërbimet e ofruara. Agjencia për regjistrimin e bizneseve (ARBK) përgatit dhe publikon, në faqen e vet zyrtare, raportet e rritjes së performancës, të cilët reflektojnë efektivitetin e shërbimeve të regjistrimit të bizneseve, që ofrohen nga zyra qendrore e ARBK-së dhe qendrat komunale të regjistrimit të bizneseve në gjithë Kosovën (<https://www.rks-gov.net>).

Agjencia për regjistrimin e bizneseve në Kosovë (ARBK), nga data 1 Mars 2015 ka lansuar programin elektronik për regjistrimin online të bizneseve. Poashtu kemi bërë unifikimin e numrit të regjistrimit të biznesit me numrin fiskal në një numër të vetëm identifikues. ARBK vazhdon të mbështet bizneset, për nga cilësia, shërbimet dhe shpejtësia, që e ofronë, ngase ne jemi “Fillimi i mbare për biznesin” (<https://www.rks-gov.net>).

Nepermjet qendrave komunale për regjistrimin e biznesit që operojnë në çdo komunë, behet regjistrimi i tyre, në mënyrë manuale dhe online, Platforma online e ofruar nga ana e ARBK-së e ka lehtëuar dukshëm këto shërbime për çdo individ që planifikon të themelojë ndonjë biznes në të ardhmen, duke ua kursyer kohën e paraqitur si vegël në web faqen e komunës duke klikuar në **<https://rbk.rks-gov.net>** direkt hyjnë në web faqen e regjistrimit, të cilën do ta japim në vazhdim si më poshtë,



ARBK AGJENCIA E REGJISTRIMIT
TË BIZNESEVE TË KOSOVËS

Identifikohu
[Shqip](#) | [English](#) | [Serbian](#)

Përdoruesi

Fjalëkalimi

[Keni harruar fjalëkalimin ?](#)

Kyçu

Nëse nuk keni llogari të hapur?
[Regjistrohu.](#)

[Udhëzuesi përdorimit](#)

©2019 - ARBK

Ne kuader te kesaj agjencie per regjistrimin e bizneseve ne Kosove munde te regjistrohen keto biznese si ne vijim:

Biznesi Individual: ne biznesin individual, pronari ka pergjegjesi te pakufizuar per te gjitha borxhet e shoqerise. shoqeria ka nje emertim zyrtar ose perfshine mbiemrin e ligjshem te pronarit dhe te perfshije shkurtesen “b.i.”

Ortakeri e Pergjithshme: te ortakrite e pergjitheshme, te gjithe ortaket pergjigjen pa kufizim, e solidarisht per borxhet e shoqerise. emri zyrtar i ortakrise se pergjithshme duhet te perfshije fjalet: “ortakeri e pergjithshme” ose shkurtesen “o.p.”

Ortakeri e Kufizuar: ne ortaklerine e kufizuar, pervec ortakëve “te pakufizuar” (ortaket qe pergjigjen pa kufizim e solidarisht per borxhet e kompanise) marrin pjese edhe ortakët “e kufizuar” ose ata ortakë, qe pergjigjen per detyrimet e kompanise deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre. emri zyrtar i ortakrise se kufizuar duhet te perfshije fjalet “ortakeri e kufizuar” ose shkurtesen “o.k.”

Shoqerite me Pergjegjesi te Kufizuara: shoqeri me pergjegjesi te kufizuara jane ato shoqeri qe jane themeluar nga nje ose disa themelues, te cilet pergjigjen per te gjitha borxhet e tyre dhe detyrimet tjera me tere asetet. emri zyrtar i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar duhet te perfshije fjalet “shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ose shkurtesen “sh.p.k.”.

Shoqerite Aksionare: shoqeri aksionare jane ato shoqeri, kapitali i te cilave ndahet ne aksione dhe qe aksionaret pergjigjen per te gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me tere asetet dhe pasurine e saj. shoqeria mund te themelohet e te kete nje ose disa aksionar. emri zyrtar i shoqerise aksionare duhet te perfshije fjalet “shoqeria aksionare” ose shkurtesen “sh.a.”.

Shoqeria e Huaj Tregtare: kompania e huaj eshte shoqeri tregtare dhe prej momentit te regjistrimit konsiderohet si dega ne kosove qe nuk ka identitet te personit juridik. pas regjistrimit i gezon te gjitha te drejtat dhe detyrimet e themeluara ne baze te ligjit te zbatueshem. emri zyrtar i deges se shoqerise se huaj tregtare ne kosove duhet te perfshije emrin e plote te shoqerise se huaj tregtare me prapashtesen “dega ne kosove” ose shkurtesen “d.k”.

Zyra e Perfaqesise se Shoqerise se Huaj Tregtare: emri zyrtar i zyres se perfaqesise se shoqerise se huaj tregtare ne kosove duhet te perfshije emrin e plote te shoqerise se huaj tregtare me prapashtesen “zyra e perfaqesise ne kosove” ose shkurtesen “z.p.k.”.

Ndermarrjet Shoqerore: ndermarrje shoqerore do te thote persone juridik qe shumica e aseteteve dhe kapitali jane pronesi shoqerore. keto ndermarrje deri ne privatizim monitorohen dhe regjistrohen nga agjensioni kosovar i privatizimit sipas ligjit nr.06/l-016 per shoqeri tregtare.

Ndermarrjet Publike: ndermarrja publike eshte ndermarrje e cila kryen veprimtarine e interesit te pergjithshme, qe eshte e themeluar nga shteti. ndermarrja publike monitorohet nga qeveria dhe organizohen si shoqeri aksionare ne perputhje me ligjin ne fuqi mbi shoqerite tregtare. te gjitha interesat pronesore ne nje ndermarrje publike do te perfaqesohen me aksione dhe te gjitha keto aksione duhet te jene te regjistruara.

Koperativat Bujqesore: koperativa bujqesore eshte nje shoqeri tregtare e kriuar nga personat fizike apo juridik te cilet duhet te jene te gjitha bujq qe kontribuojne me pronen e vet private ne kapitalin aksionar. koperativa e bujqeve themelohet nga se paku pese (5) bujq, qe jane nenshkruer te detyrimeve. koperativa nuk do te themelohet pa kapital e as nuk do te ekzistojte pa kapital. kapitali ndahet ne aksione te vleres se barabarte me vleren minimale prej 10 euro. drejtori nuk mund te jete anetar i koperatives. te gjitha keto mund te shihen ne ligjin nr.2003/9 per koperativat e bujqeve si dhe ligjin nr.03/l-004 per ndryshimin dhe plotesimin e ligjit per koperativat bujqesore nr.-2003/9 (<https://arbk.rks-gov.net>).

5.2 Lista e bizneseve që operojnë në komunën e Gjilanit dhe numrit të të punësuarëve?

5.2.1 Lista e bizneseve sipas veprimtarise dhe numrit te te punesuaresh ne komunën e Gjilanit.

Nr. Vepr.	Veprimtaria e bizneseve	Numri i bizneseve	%	Numri i pun.	%
1	Kultivimi I drithërave, kafsheve dhe shpendeve.	29	0.78	70	0.886
2	Pylltaria, prerja, shortimi.	2	0.05	3	0.037
10	Industria nxjerrëse, zhavorit, gurit dhe rërës.	18	0.49	56	0.709
15	Industria perpunuese, konservimi, mishit, vajit dhe prodhimi i Bukës.	75	2.02	211	2.671
17	Industria e tekstilit, përpunimi, prodhimi dhe fabrikimi.	34	0.92	105	1.329
19	Pregaditja e lëkurës	2	0.054	4	0.05
20	Perpunimi i drurit dhe artikujve prej druri	41	1.1	129	1.633
21	Prodhimi i artikujve prej letre	5	0.13	21	0.16
22	Shtypshkronja riprodhimi i regjistrave	19	0.51	84	1.063
24	Prodhimi i kimikaleve dhe produkteve kimike	13	0.35	14	0.177
25	Prodhimi i produkteve prej gome dhe plastike	16	0.43	47	0.595
27	Perpunimi i metaleve	2	0.054	5	0.063
28	Prodhimi i produkteve metalike, përveç makinave dhe paisjeve	60	1.62	115	1.456
29	Prodhimi i makinave dhe paisjeve	2	0.054	4	0.051
30	Prodhimi i makinave për zyre	1	0.054	3	0.037
31	Prodhimi I makinave dhe aparateve elektrike	1	0.054	1	0.012
33	Prodhimi i paisjeve medicinale	1	0.054	8	0.101
36	Prodhimi i mobiljeve, dhe industrise tjeter perpunuese	18	0.51	133	1.683
40	Furnizimi me gas, avull dhe ujë	3	0.08	16	0.202
45	Ndërtimtaria, punët përgatitore, ndërtimi i lartë, i ulët dhe punët	209	5.65	928	11.749

	përfundimtare				
50	Tregtia e mjeteve motorike, pjesëve, mirëmbajtja, lybrifikantet dhe karburantet	194	5.25	394	4.988
51	Tregtia me shumicë e ushqimit dhe materialit ndërtimor.	460	12.45	1330	16.839
52	Tregtia me pakicë	1421	38.45	2172	27.5
55	Hotele, motele restorante, kuzhina dhe përgatitja e ushqimeve.	314	8.5	765	9.685
60	Transporti tokësorë i udhëtarëve ajrorë	317	8.57	586	7.419
70	Afarizmi me pasuri të patundëshme, dhënia me qira dhe kontrolla teknike.	103	2.78	103	1.304
80	Arsimi, parashkollor, i mesëm dhe autoshkollat	38	1.02	95	1.202
85	Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	74	2	117	1.481
90	Pastrimi dhe evitimi i ujërave	3	0.081	7	0.0886
92	Sporti dhe rekreacioni	54	1.46	149	1.886
93	Veprimtari tjera shërbyese dhe sallonet e ondulimit	143	3.87	177	2.241
95	Ekonomitë shtëpiake	2	0.054	2	0.0253
	Gjithsejt bizneset që operojnë në komune, sipas veprimtarisë dhe numrit të punësuarëve.	3674	99.449	7854	99.32

Burimi: Kuvendi komunal, Drejtoria për ekonomi dhe menaxhment

Nga tabela e mesiperme, e listës së bizneseve, sipas veprimtarisë dhe numrit të punësuarëve, si kudo në Kosovë edhe në komunën e Gjiçanit, dominon një strukturë e bizneseve, jo e volitshme, ngase shumica e bizneseve janë tregtare dhe shërbyese, mbi 60% e shumë pak biznese prodhuese, që nuk garantojnë një zhvillim të shpejtë ekonomik, dhe uljes së shkallës së papunësisë, e cila për momentin është mbi 40%, nga ku edhe vijmë në përfundim, se komuna e Gjiçanit në të ardhmen duhet të përpikët që këtë strukturë të bizneseve, ta ndryshojë duke ofruar kushte më të volitshme për stimulimin e bizneseve prodhuese, që janë gjeneruesit më të mëdhenjë sa i përket vendeve të reja të punës, mandej duke i shfrytëzuar resurset jo të vogla më të cilat janë në dispozicion të kësaj komune, qofshin ato natyrore, mbetokësore, ose nëntokësore dhe resurset humane, si dhe përshtatjen e sistemit të shkollimit, që do të jenë në funksion të këtyre resurseve, të komunës sonë në fjalë (komunale, 2007).

Një iniciativë e parë e tillë është mbajturë, më 20 Nëntorë 2005 në Preshevë, pastaj iniciativa e dytë është mbajtur më 16 Shkurt 2006, në komunën e Gjilanit, që do të mirëpritet nga Qendra Rinore titulluar “Roli Mikroregjional i të rinjëve në Zgjedhjen e problemeve të tyre të përbashkëta” (Tryezë e rrumbullakët) (komunale, 2007).



- ✓ Të ndihmojmë një kontakt të tillë të rëndësishëm pas konfliktit, ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme në mikroregjion, me qëllim të kthimit të multietnicitetit më tepër sesa fjala në letër,
- ✓ Të ju ofrojnë studentëve një forum të larë bashkëveprues për diskutime në një përpjekje për të ofruar zgjedhje për të ardhmen dhe gjeneratat që do të vin pas,

- ✓ Të dëshmojnë potenciale për bashkëpunim bazë e cila tashmë ekziston, në rajon me vullnetin e manifestuar nga zyrtarët lokal komunal,
- ✓ Të iu ofrojnë mundësi të rinjëve të ndërtojnë rrjetin ndërmjet tyre në mikroregjion,
- ✓ Të fillojnë identifikimin e liderëve potencial të gjeneratës së re, të mikroregjionit dhe të inicojë modelin e bashkëpunimit ndërmjet tyre,
- ✓ Të zgjerojnë anëtarët e grupeve punuese përmes participimit direkt të NGO-ve, nga të rinjtë dhe asociacioneve të mësimdhënësve aktual dhe
- ✓ Të vazhdojë të ngrisin vetëdijen e qëllimit dhe arritjeve të projektit, përmes participimit në media dhe buletine informative të shkollave.

Pjesëmarrës ishin 30 nxënës të shkollave të mesme nga mosha, 16 deri 18 vjeç, respektivisht për të përfaqësuar komunën e Kumanovës, Preshevës dhe Gjilanit, në tryezën e rumbullakët, ishin të ftuar, nga secila komunë, prej 7 deri në 10 nxënës, 3 mësimdhënës (nga 1 deri në 2 mësimdhënës nga secila komunë), që t'i mbështesin nxënësit nga komunat përkatëse dhe 2 përkthyes nga delegacioni komunalë (komunale, 2007).

5.4 Programet zhvillimore

Si synim i grupeve punuese është marrë, sektori privat dhe publik nga “Agjenda zhvillimore komunale”

Për implementimin e suksesshëm të këtyre projekteve do të përpiqemi që të arrihet përmes:

- Buxhetit vetanak,
- Ndhmës së komunitetit ndërkombëtarë, (OJQ-ve, ndërkombëtare dhe institucioneve tjera),
- Buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe
- Donacionet dhe iniciativat afariste për qytetarët e komunës (komunale, 2007).

5.5 Vlerësimi i kapaciteteve investuese

Kapacitetet investuese dhe projektet, janë potencial i financimit ekonomikë të tyre, rrjedhimisht që ndikojnë në vlerësimet brenda projekteve të natyrës zhvillimore. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe investimet për projekte kapitale, publike dhe private.

Në rethanat aktuale në Kosovë, duke pas parasysh mundësitë e kufizuara financiare, respektivisht investimi i kapaciteteve investuese publike, dhe në sektorë tjerë të ndryshëm është me rëndësi të veçantë (komunale, 2007).

5.5.1 Investimet në komunën e Gjilanit gjatë periudhës 2008-2015

Kapacitetet investuese ndahen në kapacitete ekzistuese dhe në kapacitete të mundshme

1. Kapacitetet ekzistuese përfshijnë:

- ✓ Buxheti komunal,
- ✓ Sektori privat,
- ✓ Sektori publik,
- ✓ Burimet natyrore,
- ✓ Kapacitetet e infrastrukturës fizike (ndërtesat),
- ✓ Faktori njeri (rinia) e kështu me radhë.

2. Kapacitetet e mundëshme përfshijnë:

- ✓ Investimet e mundëshme të qeverisë,
- ✓ Investimet nga jashtë,
- ✓ Fondet ndërkombëtare,
- ✓ Pakti i stabilitetit,
- ✓ BE dhe donacionet tjera,
- ✓ Kreditë dhe grantet e ndryshme e të tjera (komunale, 2007).

5.6 Parimet e përgjithshme për zhvillim

Vizioni i komunës së Gjilanit i vendos rrotullimet e mësipërme për rreth parimeve dhe qëllimeve të zhvillimit në vijim:

- Paisjet e një infrastrukture, adekuate sociale dhe teknike, e cila ka parasysh nevojat e banorëve,
- Promovimin e ekonomisë së qëndrueshme të komunës, duke gjeneruar vende të reja pune, për banorët e qytetit,
- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit, socio – ekonomik, më të balancuar të rajonit dhe zhvillimit të konkurrencës,

- Inkurajimi i zhvillimit të gjeneruar nga funksionet urbane dhe përmirësimi i raportit, në mes të qytetit dhe fshatit,
- Ngritjen e kushteve të shëndetshme, rrjedhimisht të banueshme dhe atraktive, në zonat urbane dhe zonat rurale,
- Furnizimin e mjedisit urban dhe fshatar të mjaftueshëm, duke kontribuar në mjedisin dhe përmirësimin e kushteve elementare për jetesë,
- Mundësimi i qasjes në informata të përgjithëshme dhe njohuri,
- Eliminimi i dëmeve mjedisore,
- Përparimi dhe mbrojtja e resurseve dhe të trashigimisë natyrore,
- Promovimin e infrastrukturës për rekreacion dhe turizëm dhe
- Zhvillimin e sistemit të përshtatshëm të trafikut të transportit të lëvizshëm duke siguruar qasje të mirë urbane (komunale, 2007).


5.7 Qendra komunale për regjistrimin e bizneseve

Sipas qendrës komunale për regjistrimin e bizneseve në Gjilan, respektivisht për periudhën 2010-2015, ekzistojnë këto biznese me këtë strukturë si në vijim:

Emërtimet	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Prodhuese	24	47	96	82	78	59
Tregtare	223	202	207	173	160	139
Shërbyese	90	223	276	272	263	276
Ndërtimore	9	41	32	34	35	45
Gjithsej:	346	513	611	561	536	519

Burimi: Kuvendi Komunal, Qendra për regjistrimin e bizneseve – Gjilan.


Nga tabela shihet qartë se këto lloje të bizneseve janë biznese aktive që operojnë në komunën tonë, por unë kam kërkuar që të më sigurojnë informata prej vitit 2005-2015, me që nga kjo periudhë është parapa tema që do të hartohet në vazhdim, rrjedhimisht qendra për regjistrimin e bizneseve në nivel komunal funksionon që nga viti 2010, për at edhe nuk kanë mundur të më sigurojnë informata për vitet 2005-2009.



Burimi: Kuvendi komunal, Qendra për regjistrimin e bizneseve – Gjilan.

Nga tabela shihet qartë se këto lloje të bizneseve janë biznese aktive që operojnë në komunën tonë, por unë kam kërkuar që të më sigurojnë informata prej vitit 2005-2015, ngase me këtë periudhë është parapa tema që do të hartohet në vazhdim, rrjedhimisht qendra për regjistrimin e bizneseve në nivel komunal funksionon që nga viti 2010, për at edhe nuk kanë mundur të më sigurojnë informata për vitet 2005-2009.

Me poshte po japim ndermarrjet qe operojne ne komunen tone, qe nga viti 2010 deri ne vitin 2015, te paraqitura ne forme grafike.



Burimi: Kuvendi Komunal, Qendra per regjistrimin e bizneseve – Gjilan

Në vijim do ti paraqes edhe bizneset të cilat nuk janë aktive për periudhën e lartë cekur:

Emërtimet	2010	2011	2012	2013	2014	2015
Prodhuese	0	4	4	9	8	8
Tregtare	14	26	26	52	31	48
Shërbyese	17	39	39	48	45	51
Ndërtimore	0	4	4	5	5	8
Gjithsej:	31	73	73	114	89	115

Burimi: Kuvendi Komunal, Qendra për regjistrimin e bizneseve – Gjilan

Në bazë të informata që i posedojmë reth bizneseve jo aktive, vërehet se çdo vit shuhen shumë biznese nga lloje të ndryshme të veprimtarisë që e ushrojnë, rrjedhimisht si pasojë e mos mbijetesës, dhe mos stimulimit nga ana e nivelit komunal, por edhe nga shkalla e interesit të lartë që e ofrojnë bankat komerciale që veprojnë në vendin tonë me theks të veçantë për komunën tonë, respektivisht për nga shuarja e tyre dominojnë bizneset tregtare, e marrë në përgjithësi, viti 2015, është viti që dominon për nga shuarja e tyre.

5.8 Norma e papunesisë në komune dhe implementimi i politikave fiskale për uljen e saj

5.8.1 Zhvillimi i paplanifikuar dhe shkalla e lartë e papunesisë?

I tere zhvillimi në komune është bërë pa planifikim institucional, është bërë duplikimi i kapaciteteve dhe nuk janë shfrytëzuar resurset lokale dhe potenciale për zhvillim të qëndrueshëm në bujqësi.

Gjatë planifikimit duhet të përcaktohen menyrat për institucionalizimin, (venia në kontroll) e këtij zhvillimi, që të planifikohet zhvillimi i ardhshëm duke u bazuar në potencialet lokale (komunale, 2007).

Në bazë të qendres rajonale për punësim në komunën tonë:

- Numri i popullatës aktive është 83273,
- Numri i të punësuarëve në nivel komunal është 20457,
- Numri i punëkerkuesve aktive është 56783,
- Numri i popullatës aktive në moshe pune që nuk janë paraqitur në qendrën për punësim është 40063,
- Ndërsa përqindja e papunesisë, duke llogaritur popullatën aktive për punë, është 43%.

Sipas shenimeve te qendres rajonale per punesim numri me i madhe i te papuneve te regjistruar ne baze te grup moshave eshte ne mes 25-39 vjeç, reth 49.60 %, mandej edhe poltikat e punesimit duhet te fokusohen me shume ne kete grup moshe (Osmani, Mahmuti, Hyseni, & Ismajli, 2005).

5.9 Lista e ndermarrjeve te anketuara ne baze te pyetesoreve qe i posedojme dhe rezultatet e tyre

Duke u bazuar ne 55 pyetesoret qe i posedojme, nga anketimi i ndermarrjeve ne komunen e Gjilanit, rrjedhimisht ne vazhdim ne menyre detale, po japim nje analize statistikore, per ndermarrjet qe ushtrojne veprimtarine e tyre biznesore, respektivisht per keta sektore: tregtare, prodhuese dhe sherbyese.

Duke marre per baze pyetesoret dhe anketimin e ndermarjeve ne komunen tone kemi kete strukure te paraqitura ne forme tabelare.


Tabela nr. 1 Sektoret e ndermarrjeve te anketuara ne komunen tone.

	<i>Frekuencat përqindje</i>	<i>në Frekuencat absolute</i>
Prodhuese	30.91	17
Tregtare	43.64	24
Sherbyese	25.45	14
Gjithsej	100	55

Sipas tabelës se lart shenuar shihet qart se nga ndermarrjet e anketuara, dominon sektori tregtar, per nga numri i tyre me 24 sosh, ndersa ne perqindje me 43.64%, mandej vjen sektori prodhues, me 17 ndermarrje ndersa te shprehura ne perqindje me 30.91% dhe sektori i fundit eshte sektori sherbyes me me pak ndermarrje dhe me numer me te vogel ne perqindje me vetem 14 dhe 25.45%.

Ne vazhdim kete strukture te ndermarrjeve ne forme tabelare do te paraqesim edhe grafikisht ne forme te diagrameve:


Grafiku 1. Ndermarrjet e anketuara sipas sektoreve



Nga anketimi i ndermarrjeve te realizuara kemi kete forme te rezultateve sa i perket zonave urbane dhe rurale si ne vijim:

Ne grafikun ne vijim verejme se zona urbane eshte me e favorshme per te bere biznes ne raport me zonen rurale, rrjedhimisht nga 55 ndermarrjet e anketuara, vetem 5 prej tyre i takojne zones rurale, qe ne perqindje eshte 9.10% ndersa zona urbane ngelet zona me me se shumti biznese te anketuara, respektivisht me 50 sosh dhe me nje perqindje te larte, 90.91%.

Grafiku nr. 2 Ndermarrjet e anketuara sipas zonave urbane dhe rurale.



Nga tabela e meposhtme vërehet se 87.27%, janë të gjinisë mashkullore dhe 12.73% janë të gjinisë femerore.

Nga tabela e meposhtme shihet se të moshës 18-30 vjeç janë 23.64% e pyetesoreve të anketuar, ndërsa të atyre 30-40 janë 41.81% e pyetesoreve të anketuar, të moshës 40-50 janë 23.64% e pyetesoreve të anketuar, dhe mbi moshën 50 vjeç janë 10.91% e pyetesoreve të anketuar.

Tabela 4: Moshë

	<i>Frekuencat përqindje</i>	<i>në Frekuencat absolute</i>
18-30 vjeç	23.64	13
30-40 vjeç	41.81	23
40-50 vjeç	23.64	13
Mbi 50 vjeç	10.91	6
Gjithsej	100.00	55


Ne bazë të pyetesoreve për ndërmarrjet e anketuara sa i përket arsimimit, 20% janë me shkollim të mesëm, 41.82% janë me shkollim të lartë, dhe 38.18% janë me shkollim superior.

Tabela 5: Arsimimi në bazë të pyetesoreve të anketuar:

	<i>Frekuencat përqindje</i>	<i>në Frekuencat absolute</i>
Fillor	0.00	0

I Mesem	20	11
I Larte	41.82	23
Superior	38.18	21
Gjithsej	100,00	55

Grafiku 6: A ka ndikuar privatizimi i ndermarrjeve publike ne krijimin e biznesit tuaj?




Ne grafikun ne vijim verejme se sa i perket elementeve specifike te suksesshme te qeverise komunale, nga anketimi i ndermarrjeve te realizuara respektivisht kane dhene kete rezultat: **Masat e ndermarra kunder korrupsionit jane me 32.72%**, qe do te thote pak, **Sjellja e mire e punetoreve komunal jane me 54.55%**, qe vleresohet nga kategoria e 1 me shkelqyeshem, **Te sakte ne kohe jane me 65.45%**, nga ku kjo kategori do te thote pak, **Aftesia per te zgjidhur probleme jane me 65.45%**, rangohet ne katrorin numer 2 qe do te thote pak, **Eshte lehte te kontaktohet personi i duhur eshte me 56.37%**, nga ku eshte ranguar ne katorin nr.1 qe jep rezultat te shkelqyeshem, dhe katori i fundit eshte **Efektshmeri**

e pergjithshme me 70.90%, ku do te thote pak. Kete tabele me keto te dhena te siper shenuara do te paraqesim edhe grafiksht si ne vijim.

Duke u bazuar ne tabelen e mesiperme dhe ne anketimin e ndermarrjeve ne komunen tone, kemi konstatuar se shumica prej tyre, pak jane te kenaqur me sherbimet qe i ofron komuna, duke e stagnuar at ne shume fusha, me te cilen ka mundesi me ua ofru secilit qytetar, rrjedhimisht veprimtarive biznesore, nga ku nje pjese e madhe e zhvillimit ekonomik lokal, eshte e perqendruar pikerisht ne keto biznese.


Grafiku 7: Klasifikoni elementet specifike te suksesshme te qeverise komunale?



Ne grafikun 7 jane dhene te dhenat per sa i perket disa elementeve te sherbimeve te qeverise komunale.

Ne grafikun ne vijim shihet se 23.64%, kane thene se ndikon politika ne biznesin e tyre, dhe 76.36% kane thene se nuk ndikon politika ne te berit biznes ne komunen tone.

Grafiku 8: A ndikon politika ne biznesin tuaj?



|

Konkluzione dhe rekomandime

Per hartimin e nje strategjie te programuar dhe te planifikuar per zhvillimin ekonomik te komunes se Gjilanit, duke u bazuar ne resurset dhe kapacitetet e burimeve natyrore, rrjedhimisht atyre njerezore, poashtu duke u bazuar ne trendet dhe kahjet aktuale ne vend dhe ne botë, si dhe duke pasur parasysh edhe trendet tradicionale te zhvillimit ekonomik te komunes sone, paraprakisht duhet t'i analizojme gabimet e bera qe te njejta mos t'i perserisim, si dhe te mesohemi nga pervoja e komunave te tjera ne vend dhe jashte vendit.

Kjo analize do te merre nje kohe te konsiderueshme, une ne vijim te punimit te kesaj teme jo te lehte dhe te kompleksuar sado pak jam munduar qe t'i percaktoje kahjet e zhvillimit ekonomik te komunes se Gjilanit sepse perpilimi i strategjive te mirefillta behet nga grupet e eksperteve te lemive te ndryshme, por e njejta do te jete nje baze e shendoshe per mundesimin e vazhdimet te perpilimit te nje strategjie te zhvillimit ekonomik te planifikuar dhe kordinuar prej nivelit qendrore siq eshte (Qeveria e Kosoves), respektivisht edhe te komunes sone.

Duhet te dijme qe ndryshimi i shpejte i dinamikes ne botë, komunikacioni modern dhe mundësit e reja te informimit kane rezultuar qe bota te jete e vogël. Kështu në tregtinë ndërkombëtare është krijuar një mjedise me konkurrencë shumë të ashpër. Nën këto kushte të konkurrencës së krijuar, zhvillimi ekonomik i vendit mundësohet vetëm me ndihmën institucionale, si dhe me mbështetjen qe ka ne fokus forcimin dhe zhvillimin e bizneseve private qe do te reflektojnë ne zhvillimin ekonomik.

Prej subjekteve komunale dhe atyre qeveritare ne rend te pare duhet pritur qe bizneseve private te iu mundësohet infrastruktura ligjore dhe ajo urbane ne mënyre qe bizneset te kenë mundësi te fillojnë aktivitetin e tyre me nje start te sigurt dhe me baze te shëndoshe te veprimit, si dhe te kenë me lehte dhe sigurt qe te bëjnë investime ne rritjen e sasisë se prodhimeve dhe shërbimeve te tyre, rrjedhimisht duke i'u mundësuar shtimin e kapaciteteve qe te vije deri te hapja e vendeve te reja te punës, qe do te rezultonte ne rritjen ekonomike ne nivel lokale dhe ne ate qendrore (Kosove).

Ne anën tjetër me shërbimet dhe punën institucionale, komuna duhet te ketë parasysh nevojat dhe obligimet e popullatës dhe te bizneseve ne kuadër te hapësirave dhe fushave te

përmendura ne kapitujt e këtij punimi. Duke e ditur qe komuna duhet te jete ne shërbim te popullatës, te bizneseve dhe ushtruesve te veprimtarive te ndryshme, prej te cilave edhe e formon buxhetin komunale, përmes sistemit te taksave komunale, te njohura si te hyra vetanake, respektivisht duhet qe komuna te punoje dhe te realizoje sa me shpejte hartimin e strategjisë se zhvillimit ekonomik, përmes se cilës këto shërbime do te jene me efikase dhe efektive, qe do te mundësonin një zhvillim me te hovshëm dhe te planifikuar te komunës.

Ne kuadër te strategjisë se zhvillimit ekonomik qe vlen te theksohet është pjesa e planit gjeneral dhe e atij detal urbanistik, me te cilën do ti mundësohet popullatës, ne mënyre te thjeshte dhe me praktike te vijnë deri te një hapësire moderne e veprimit, ekonomive bujqësore, mundësi me efikase te veprimit ne forme bashkëkohore, si dhe fillimi i kujdesit dhe menaxhimit te hapësirave te mbrojtura me infrastrukturat përcjellëse te skjaruara, ne hapësirat e përmendura me aktivitetet e skjaruara.

Si do qe te jete ekonomia e komunës se Gjilanit është vazhdimisht e ballafaquar me probleme te shumta, duke stagnuar ne shume fusha te ndryshme, siç është: Procesi i privatizimit, Ndërmarrjet e vogla dhe te mesme (NVM-te), me theks te veçantë sektori privat, Bujqësia e kështu me radhe.

Për te ule shkallen e papunësisë qe por momentin është alarmante si ne nivel lokale poashtu edhe ne ate qendrore si dhe per te gjeneruar sa me shume vende te reja pune, duhet te ndërmerren hapa sa i përket sektorit privat, rrjedhimisht ndërmarrjet e vogla dhe te mesme (NVM-te), duke i stimuluar me grande dhe subvencione si dhe ne thithjen e Investimeve te huaja direkte (IHD) ne nxitjen e këtyre ndërmarrjeve ne veprimtari prodhuese.

Kryesisht do te përqendrohem ne zhvillimin ekonomik ne nivel lokale, me këtë problematike do te merrem edhe ne te ardhmen.

Kjo pjese eshte e korrigjuar te lutem kontrolloj fjalet germa ë ju mungon.....mundesisht ia jep dikujt per lektorim.....

Bibliografia

(a.d.). Gjetur May 12, 2019, nga <https://www.rks-gov.net>: <https://www.rks-gov.net/AL/f24/sherbimet-per-biznese/zhvillimi-i-biznesit>

(a.d.). Gjetur May 12, 2019, nga <https://arbk.rks-gov.net>: <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,32>

Drejtoria per zhvillim ekonomik, K. e. (a.d.). Gjetur 14 May, 2019, nga <https://kk.rks-gov.net>: <https://kk.rks-gov.net/gjilan/zhvillim-ekonomik/zonat-ekonomike/>

ekonomik, M. e. (2013). *Politikat e sektorit te komunikimeve elektronike - Agjenda digjitale per Kosoven, 2013 - 2020*. Prishtine: Ministria e zhvillimit ekonomik.

Gap. (2012). Ligji per zonat ekonomike: ndikimi i tij ne zhvillimin e parqeve te biznesit. *Instituti per studime te avancuara gap* , 1-13.

ISLAMI, X., & MULOLLI, E. (2016). Drejtimi i politikave qeveritare ne mbeshtetjen e NVM-ve ne Kosove. *Reforma* , 163-170.

komunale, G. i. (2007). *Plani zhvillimor komunal*. Gjilan: Kuvendi komunal Gjilan.

lokal, M. e. (2016). *Strategjia per veteqeverisje lokale 2016 - 2021*. Prishtine: Qeveria e Kosoves.

menaxhment, D. p. (2007). *Zona Industriale*. Gjilan: Kuvendi i komunes - Gjilan.

Murmullaku, B., Hoxha, D., & Ukaj, M. (2014). *Trendet e zhvillimit te NVM-ve ne Kosove*. Prishtine: Kolegji universitar "FAMA".

Osmani, F., Mahmuti, B., Hyseni, S., & Ismajli, H. (2005). *Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal 2005 - 2007*. Gjilan: Riinvest.

Rajonipress. (2018, April 08). Gjetur May 12, 2019, nga <https://rajonipress.com>: <https://rajonipress.com/ministria-e-financave-liron-nga-tatimi-doganor-e-akciza-disa-produkte/>

Shiroka - Pula, J. (2013,). *Sfidat dhe perspektiva e NVM-ve ne Kosove*. Prishtine: Artini.

support, K. c. (2017). *Strategjia per Grate ndermarrese ne komunet e Gjilanit per periudhen 2017 - 2021*. Prishtine: Kosovo center for business support.

Sylqa, D. (a.d.). Sfidat dhe efektet e privatizimit ne Kosove. *Instituti per hulumtime dhe konsulence, Universiteti "Universum"* , Prishtine , 1-21.

Sylqa, D., & Kastrati, F. (2013). Politika fiskale dhe reflektimi i saj ne zhvillimin ekonomik. *Kolegji evropian Dukagjini* , 17-26.

Tolaj, S. (2015, August 24). Gjetur May 12, 2019, nga <https://www.gazetaexpress.com>:
https://www.gazetaexpress.com/shkurt-e-shqip-politikat-fiskale-si-sfide-e-zhvillimit-ekonomik-ne-kosove-124949/?archive=1?utm_source=referral&utm_medium=web&utm_campaign=copyright

APENDIX

PYETESORI

Ne baze te ketij pyetesori ne pretendojme te identifikojme se si jane zhvilluar bizneset ne komunen e Gjilanit, dhe si ka ndikuar privatizimi i ndermarrjeve publike ne hapjen e vendeve te reja te punes dhe ne uljen e shkalles se papunesise ne komunen tone, duke analizuar hap pas hapi dhe duke ardhur ne perfundim per t'ua lehtesuar punen nga ana e nivelit komunal me sherbime te reja sa i perket infrastruktures elektronike respektivisht per bizneset te cilat ekzistojne por edhe atyre qe do te themelohen ne te ardhmen qe te jene bartese te zhvillimit ekonomik.

Ky pyetesor me nevojitet per punim te diplomes ne studimet master.

Ju lutem lexoni me kujdes pyetjet deri ne perfundim dhe jepni mendimet e juaja reth biznesit tuaj.

1. Vendbanimi

Gjinia

M

F

2. Mosha (Ciles grup moshe i takoni)?

1. 18-30 Vjeç

Arsimimi:

2. 30-40

1. Fillor

3. 40-50

2. I Mesem

4. Mbi 50 Vjeç

3. I Larte

4. Superior

3. Cili eshte lloji i biznesit me te cilen merreni?

4. Sa vite merreni me kete lloje biznesi?

5. Cilat jane lehtesimet e infrastruktures elektronike ne ofrimin e sherbimeve te ndryshme komunale, si dhe ne berjen e biznesit?

6. A ka ndikuar Privatizimi i ndermarrjeve publike ne krijimin e biznesit tuaj?

1. Po

2. Jo

Arsyet tjera _____

7. A mendoni se shërbimet komunale online ua lehtësojnë punën në realizimin e planeve për biznesin tuaj?

➤ Klasifikoni elementet specifike të suksesshme të qeverisë Komunale?

(Vendos X në kutinë përkatëse)

	1	2	3	4	5
Masat e ndërmarra kundër korrupsionit.	Shumë ☐	Pak ☐	Aspak ☐	Nuk e di ☐	
Sjellja e mirë e punëtorëve komunal.	Shumë ☐	Pak ☐	Aspak ☐	Nuk e di ☐	
Të saktë në kohë	Shumë ☐	Pak ☐	Aspak ☐	Nuk e di ☐	
Aftësia për të zgjidhur probleme	Shumë ☐	Pak ☐	Aspak ☐	Nuk e di ☐	
Është lehtë të kontaktohet personi i duhur	Shumë ☐	Pak ☐	Aspak ☐	Nuk e di ☐	
Efektshmëri e përgjithshme	Shumë ☐	Pak ☐	Aspak ☐	Nuk e di ☐	

8. A ndikon politika ne biznesin tuaj?

1. Po

2. Jo

Nese po arsyeto _____

9. Cilat jane sfidat me te cilet ballafaqohen bizneset ne komunen tone dhe cilat jane shkaqet qe papunesia eshte ne shkalle kaq te larte?

Nenshkrimi: _____

Vula:

